


# KORÇA ERE

**ALMANAK**


**1976**



# KORÇA E RE

ALMANAK

— 1976 —



SHTËPIA BOTUESE «8 NËNTORI»

Pregatitur nga Shtëpia e Kulturës dhe e Krijimtarisë Popullore dhe Dega e Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve të rrethit të Korçës.



Sekretar i Komitetit të Partisë të  
rrethit të Korçës

**DEKADA PUNE E LUFTE, DEKADA FITORESH**

Ditën e 24 tetorit 1944 Korça e traditave të lashta patriotike për herë të parë shkëlqeu nga gëzimi i fitores, nga dielli i lirisë së vërtetë që solli Partia.

Liria lindi nga gryka e pushkës. Historia e Korçës -- «Plakë», u shkrua me luftën e gjakun e bijve dhe bijave të saj, që nuk u përkulën kurrë para armikut, që i dolën në çdo kohe zot vendit, duke e kaluar lavdinë e kësaj toke nga njeri brez në tjetrin. Korça e Themistokli Gërmenjit, Mihal Gramenos e Naum Veqilharxhit e Spiro Ballkamenit dhe e luftëtarëve të tjerë të pushkës e të penës të Rilindjes Kombëtare; e demonstratave të mëdha të bukës në vitin 1936 dhe e asaj të 7 Prillit 1939; Korça ku jetoi për një kohë dhe zhvilloi veprimtari të shquar revolucionare themeluesi i Partisë sonë shoku Enver Hoxha, vendi i dëshmorit të parë komunist, Heroit të Popullit Koci Bako, u ngrit e tëra me thirrjen e Partisë. Bijtë e saj për të cilët liria e Atdheut është gjëja më e shtrenjtë, dolën maleve e u bashkuan me ushtrinë partizane. Pushka e tyre, pushka e luftëtarëve të popullit kryengritës, nuk rreshti për asnjë çast gjer ditën e Çlirimit. Çdo pëllëmbë e kësaj toke ka një histori të sajën, është përzhitur nga flaka e barutit, është spërkatur me gjakun e luftëtarëve trima që dhanë jetën për nderin dhe lavdinë e Atdheut.

Agoi dita e lirisë, por lufta nuk mbaroi. Filloi lufta për rimëkëmbjen e vendit të shkatëruar dhe transformimet socialiste të tij, luftë politike, luftë ekonomike, luftë në frontin ideologjik. Partia me largpamësi e përcaktoi mirë këtë rrugë. Transformimi i vendit kërkonte të ngrihej në këmbë i madh e i vogël. Thirrjes së Partisë iu përgjegjën, ashtu si në luftë



për liri komunistët, punëtorë e fshatarë, gruaja, rinia e inteligjencia popullore. Dhe lulet e para të ndërtimit socialist lindën mbi një terren e mbi një bazament të shëndoshë, në luftë të ashpër me armiqtë dhe sabotatorët.

Partia tha të thahet kënetat e Maliqit. Të gjithë u rrjeshuan në frontin e punës dhe duke punuar me heroizëm e duke kaluar çdo vështirësi e thanë këtë kënetë që ishte bërë fole mushkonjash, varfërie e sëmundjesh. Toka që prej shekujsh dergjej nën ujërat e turbullta, u çlirua, duke u kthyer në tokë pjellore të begatshme.

Dhe pastaj vitet e pesëvjeçarit sollën njeri pas tjetrit shumë fabrika e uzina, që rritnin vazhdimisht peisazhin industrial të qytetit. Dhe ky peisazh u krijua pothuajse nga hiçi. Nëpër rrugicat e ngushta të «pazarit» të vjetër, prapa qepenave prej dërrasash e dyerve të vjetra, i cili tani po restaurohet e po kthehet në muze, dikur ndiheshin regëtimat e kacakëve të kovaçit, çomagia e drunjte e teneqexhiut, gërshëra e rrobaqepësit që priste shajak të vjetër, çekiçi i kundraxhiut që bënte këpucë e vetë kurrë s'veshi këpucë të reja. Këto dhe ndonjë fabrikë e vogël apo punishte primitive me gjithë — gjithë 200 punëtorë, përbënin «industrinë» e Korçës së paraçlirimit. Dhe të mos harrojmë se atëherë Korça kishte «privilegjin» të quhej qytet industrial. Kurse tani? Ndryshimet e viteve nuk mund të maten as me shekuj. Aty ku diku, tri dekada e ca më parë, në hyrje të Korçës, ngriheshin godina të vogla qerpiçi të shkatërruara, simbol i jetës me derte e halle, ngrihet zona industriale e qyteti: kombinati i trikotazhit, uzina e instrumentave, fabrika e veshjeve dhe e këpucëve, ofiçina mekanike bujqësore, TEC-i i Korçës etj. Oxhaku i tij filloi të nxjerrë tym në vitin e 30 vjetorit të themelimit të Partisë, më 1971. Ai prodhon jo vetëm energji elektrike dhe avull për industrinë, por, shërben edhe për ngrohjen e apartamenteve të qytetarëve. Gjer tani ngrohja është futur në 800 apartamente, ndërsa deri në vitin 1980 do të marrin ngrohje prej tij 2400 apartamente. E këtu s'ka asgjë të jashtëzakonshme. Por duke folur për të sotmen e për të ardhmen, s'ka se si mos të hedhësh vështrimin në të kaluarën, përpara «kohës së Partisë», të shkëputësh fakte e ngjarje, krahasimi i të cilave me të tashmen e bukur, nxjerr më mirë në pah ma-çhështinë e veprës së Partisë. Më 1935 u ndërtua hidrocentrali i Vithkuqit, hidrocentral ky i pari në Shqipëri. Në dhjetë vjet vetëm kjo «vepër» mundi të ndërtohej nën re-



gjimin e Zogut. Dhe mbureshin gazetat dhe kalemxhinjtë për të. Diçka për të qeshur. 300 kilovat ishte kapaciteti i tij. Krahasoni këtë me TEC-in, e Korçës, të Maliqit apo me veprat e tjera energjitike që janë ngritur dhe po ngrihen në vendin tonë siç është Bistrica, Shkopeti, Vau i Dejës, Fierza...

Po le të kalojmë në anën tjetër të çështjes: Dha dritë ai atëherë, po për kë «... do t'i japë dritë popullit të qytetit», shkruante atë kohë gazeta borgjeze e Korçës. Ç'hipokrizi! Drita erdhi në qytet, por ajo hyri në shtëpitë e tregtarëve e pasanikëve. Ata që i kanë jetuar ato kohë të tregojnë se vetëm për të bërë instalimet e brendshme në një dhomë, një punëtori i duhej të punonte tre muaj rrjesht, kurse për taksën mujore të dritës të linte gati gjysmën e rrogës. Ja pse drita elektrike mbeti vetëm e drejta e atyre që kishin para. Një kontrast i madh: në të njëjtin qytet, në të njëjtën rrugë, shtëpi ku ndriçonte drita elektrike dhe shtëpi ku sa dukej drita e kuqërremtë e llambës me vajguri dhe e kandilit. Kështu zvarritej jeta. Kurse sot? Drita elektrike ndriçon çdo shtëpi. Edhe në zonën më të thellë malore, në çdo shtëpi ka hyrë radioja. Televizorin, makinën larëse, frigoriferin tani e gjen si diçka të zakonshme jo vetëm në qytet, por edhe në shumë familje fshatare.

Korça tani ka industrinë e vet shumëdegëshe, industrinë e lehtë dhe të rëndë, industrinë mekanike dhe atë ushqimore, së cilës i shtohen vazhdimisht uzina e fabrika të reja. Por Korça veç këtyre, ka edhe diçka më të rëndësishme e më të madhe: njeriun e ri të punës që është kryevepra e Partisë, ndërtuesin e ndërgjegjshëm të socializmit, atë njeri që i frymëzuar nga idetë e Partisë po ia ndryshon çdo ditë e më shumë pamjen qytetit e rrethit. Dhe jo vetëm pamjen. E kjo, sepse kurdoherë është mbajtur parasysh porosia e Partisë që transformimet socialiste të thella e të mëdha nuk mund të realizohen pa ecur me hapa të sigurt në rrugën e transformimit të njeriut të ri. U rrit në vitet e epokës së Partisë një klasë punëtore që kudo, në çdo fushë, po i jep tonin e jetës. Në krahasim me vitin 1938 numri i punëtorëve në rrethin e Korçës është rritur mbi 37 herë. Dhe kjo nuk është një rritje e thjeshtë numerike. Në këto dekada të Partisë është rritur një klasë punëtore me pjekuri politike, me bindje të thellë ideologjike, me guxim të madh, e gatshme për të marrë dhe zbatuar objektiva gjithnjë e më të mëdha që i ngarkon koha dhe Partia.



Është pikërisht kjo pjekuri, ky besim i patundur i klasës punëtore të rrethit tonë në vijën e përgjithshme të Partisë që e ka bërë atë të hidhet tërësisht në rrugën për zbatimin e detyrave për transformimet socialiste, duke patur kurdoherë parasysh porosinë e Partisë të mbështetjes në forcat e veta. Çdo vepër, çdo pesëvjeçar mban vulën e punës dhe djersës së klasës punëtore, fshatarësisë kooperativiste, inteligjencies popullore, rinisë sonë heroike. Dhe çdo pesëvjeçar ka sjellë hapa të reja zhvillimi, rritjeje edhe në Korçë. Faktet e shifrat flasin më mirë se kushdo tjetër për këtë ndryshim të madh. Hapat e këtyre dekadave janë hapa shekujsh, transformimesh edhe në industrinë e Korçës, që i jep atij në radhë të parë fizionominë socialiste. Në epokën tonë edhe nga kjo pikëpamje rilindi qyteti i Korçës. Tani pulsi industrial i tij po rreh e po bëhet gjithmonë e më i fuqishëm, më i ndjeshëm. Atë çka prodhonte (prodhim me vleftë) gjithë «industria» e Korçës më 1938, tani e prodhon vetëm ndërmarrja e material-ndërtimit në disa ditë. Duke vazhduar krahasimin mund të përmendim se prodhimi i përgjithshëm industrial (në vleftë) i rrethit të Korçës më 1975 ishte 63.6 herë më i madh nga çka prodhonte gjithë Shqipëria më 1938. Sot rrethi ynë prodhon 8.2 herë energji elektrike, 64 herë qymyr, 5.3 herë më shumë tulla nga sa prodhonte gjithë Shqipëria në vitin 1938. Po ritmet nuk mund të maten vetëm me kohën e paraqirimit, por edhe duke krahasuar njërin pesëvjeçar me tjetrin. Në krahasim me vitin 1970, më 1975 në rrethin e Korçës u prodhua 2 fish energji elektrike, u rrit gati dy fish prodhimi i industrisë mekanike, një herë e gjysmë prodhimi i trikotazheve, i sheqerit etj. Në këtë pesëvjeçar do të ketë lartësi të reja në industrinë e rrethit tonë.

Fitoret e reja janë arritur edhe në sektorin e bujqësisë. Fusha e Korçës tanimë është ndryshuar dhe begatuar nga puna dhe djersa e njerëzve tanë. Ajo po rinohet e po bëhet edhe më e begatshme. Po rriten nga viti në vit veprat ujitëse e bonifikuese. Me përfundimin plotësisht të kompleksit të madh hidroteknik me bazë rezervuarin e Gjançit, i cili u inaugurua në jubileun e 35 vjetorit të Partisë dhe që është një liqen i vërtetë në gji të maleve, do të rritet aftësia ujitëse edhe në 4.800 hektarë të tjerë. Në këtë mënyrë do të vihet nën ujë pothuaj e gjithë fusha e Korçës. Është rritur dhe vazhdon të rritet mekanizimi në bujqësi, mekanika bujqësore po thotë fjalën edhe në fushë edhe në malësi. Ajo as që mund të krahasohet me të kaluarën.



Për të dhënë një ide për këtë mjafton të përmendim faktin që sot nuntri i traktorëve dhe makinerive bujqësore që janë në kooperativën e tipit të lartë të Pojanit është shumë më i madh nga ai që kishte SMT-ja e rrethit në vitet e para pas Çlirimit.

Këto kushte të favorshme dhe puna plotë vetmohim e fshatarësisë kooperativiste, futja gjithmonë e më shumë e eksperiencës së përparuar dhe shkencës në bujqësi, ka bërë që të rriten nga viti në vit rendimentet dhe prodhimi në kulturat bujqësore. Në vitin 1976 si rreth u arrit në drithërat e bukës një rendiment prej 29.4 kv. për ha, nga 17.9 për ha që u muar në vitin 1970. Vetëm grurë ju dha shtetit 50.000 kv mbi planin. Rritje të ndieshme ka pasur edhe në kulturat e tjera si në panxhar sheqeri, patate, perime etj. Ndërsa me kohën e paraçlirimit as që mund të bëhet krahasim. Në vitin 1976 vetëm NB-ja e Maliqit, kooperativa e Bili-shtit dhe ajo e Menkulasit të marra së bashku prodhuan më shumë grurë nga ç'realizoi gjithë rrethi i Korçës në vitin 1938.

Dora e bujkut korçar i ka hyrë punës për transformimin e natyrës. Mbi shtratin e ish-kënetës së dikurshme u ngrit ndërmarrja bujqësore e Maliqit, në tokat e pasura të sëcilës merren mesatarisht mbi 40 kv grurë dhe më shumë se 400 kv panxhar sheqeri për hektar; Në tokat gjysmë ranore të zonës së Dvoranit dhe Kamenicës, ku me zor mbinte gjëmbi, e kodrat përrreth, ku vetëm ferra dhe dëllinja rritej, u krijua plantacioni i madh i mollëve, rrushit, kumbullave, çardhave etj, me një sipërfaqe të përgjithshme prej 926 hektarësh. Vetëm mollë ky plantacion ka 76.600 rrënjë. Në faqet e kodrave të maleve gjer në lartësitë e Moravës e të Lenijes u hapën toka të reja dhe lulëzoi bimësia e kultivuar, u mbollën gruri, patatja, pemë frutore dhe drurë pyjorë. Gjatë pesëvjeçarit të pestë në të gjithë rrethin u çelën 5.281 hektarë tokë e re buke, pa zënë në gojë këtu atë që u mboll me vreshta e dru frutorë.

Është rritur prodhimi, është ngritur e ngrihet vazhdimisht mirëqënia në qytet e në fshat. Kalon tani nëpër rrugët e qytetit të Korçës dhe nëpër fshatrat socialiste si në ato të fushës, ashtu edhe të malësisë së Gorës, Vithkuqit e Oparit dhe në çdo hap ndihet atmosfera e jetës së kultivuar. Nuk ka fshat pa shkollë, të gjithë fëmijët që mbarojnë ciklin e ulët vazhdojnë ciklin e lartë të shkollës 8 vjeçare. Është shtuar në mënyrë të pakrahasueshme arsimit i mesëm. Nga një shkollë e mesme që ishte para Çlirimit dhe



## MANUSHAQJA

*(Tregim i jetuar)*

Në sallë bënte nxehtë, ndaj dikush u ngrit dhe hapi dritaren në të dy kanatat. Menjëherë hyri ajri i ftohtë e të gjithë e ndjenë flladitjen. Tymi i duhanit u dynd jashtë si mjegull.

Dita po thyhej fare pa u ndjerë. Asnjë nuk tha të bëhej pushim, megjithëse kishin kaluar dy orë nga pushimi i parë. Fjalën e mori një vajzë, brigadiera e brigadës së dytë. Ajo u ngrit, u ra flokëve me dorë që të zbulonte tërë fytyrën, ktheu sytë nga dritarja e hapur, pastaj shikoi nga presidiumi. U mbush me frymë dhe foli:

— Në brigadën tonë ka më pak krahë punë, por planin e grurit, të fasules e të patates e realizuam. Këto ditë përfunduam edhe një hektar qilizmë. Edhe plehun e shpëmë në parcelë sipas grafikut. Sa për veten time, kam katër vjet që po bëj nga 400 ditë pune. Këtë vit them se do të bëj edhe ca më shumë; jo vetëm unë po edhe anëtarët e tjerë. Këtë përgjigje i jap Dules unë — iu drejtua një burri hijerëndë që rrinte dy rreshta përpara saj.

Fshatarët lëvizën dhe kthyen kokën nga Dulja, brigadieri i brigadës së tretë, i cili s'kishte mbajtur asnjë të metë përsipër. Dulja ngriti kokën mengadalë dhe e treti shikimin e ftohtë mbi Manushaqen. Në atë çast u bë edhe më i vrejtur, e sikur u shëntua disi.

— E de, se e morëm vesh punën tënde, — filloi Dulja me zë të shtruar e të thellë. — Po pse s'na thua ç'tokë kini ju e ç'tokë kemi ne. Brigadës së dytë i ka rënë tokë e mirë, këtë s'e fshihni dot, ndaj ke edhe gojën brisk ti. I tha këto fjalë me një ton ironie. — Ja si është puna, — u kthye përpara — dheu s'është një kudo, këtë e dinë edhe kalamajtë. I ka rënë tokë e butë, e majme dhe e ronitur brigadës së



dytë, kurse ne na ra në hise tokë e verdhë, tokë që kërkon shumë e të jep pak, tokë që të pëlçet buzën.

— Ç'thua mor Dule. Hajt se po e këmbejmë tokën — brofi Manushaqja, e prekur. Jo, jo, nuk i gëlltitim këto profka ne, hajt i këmbejmë dhe le të shikojmë kush e ka fajin.

— Epo kështu është, moj; përse kundërshton.

— Dale, dale se s'je në brazdë, o Dule, — u ngrit Vaska, një djalë i gjatë, që gjer në atë çast s'kishte hapur gojë. — Unë jam kundra Dules. Vërtet që dheu s'është një, ama që ti t'ja hedhësh fajin tokës kjo s'pi ujë fare de. Pse o Dule, s'na thua këtu, kur dalin në punë anëtarët e brigadës suaj? Këta të brigadës së tretë, o shokë, ia shtrojnë me muhabet e me duhan që ç'ke me të. Apo s'dalin vonë. Bjeri drejt, Dule, mos na sill rrotull si kali në vrah.

Dulja, befas, shkrofëtiti e tundi kokën. Fjalët e Vaskës i kishin futur flakën e pa ua vënë veshin romuzeve që po hidhnin njerëzit në sallë, picërroi sytë e u mat të fliste, por atëherë salla gumëzhiti dhe nuk e lanë të hapë gojën. E vunë përpara Dulen.

— Ta dëgjuam këngën...!

— Leri profkat, Dule!

— S'të shkojnë këtu. Në ke për të thënë ndonjë fjalë të saktë, mirë, përndryshe ulu dhe veri gishtin kokës, — shtoi Vaska, në mes të zhurmës.

— E po s'jemi në pazar de, — u dëgjua zëri i Ridvanit.

— Do të më lini të them nja dy fjalë edhe unë apo të ulem prapë.

— Prisni të dëgjojmë Ridvanin, — tha një shok nga presidiumi. U bë heshtje.

— Ja ç'dua të them unë — nisi Ridvani. — Pleqtë na e kanë lënë një fjalë me mend: «S'ka faj toka, po ka faj koka». Prandaj unë them që këtë fjalë ta mbajmë mend dhe asnjëri nga ne të mos e harrojë. Mor edhe nëpër muqet, nëpër shtëpi ta shkruajmë. E do puna ta bëjmë kështu, se sa për krahët njësoj i kemi, duar unë, duar ti. Ama, kur vjen puna, edhe plisat u dashka t'i thërmosh me pëllëmbë, pa mos druani, se nuk hahet lëkura, ja kështu them unë.

Kaq foli Ridvani e u ul me zhurmë në stol.

— Të lumtë goja Ridvan.

— Ridvani i ka fjalët të shkurtëra — tha me entuziazëm Manushaqja. Puna, puna vetëm ajo të nderon. I përtuari i nderuari, thotë populli.

Tek po e vështroja Manushaqen, ndjeja një farë kureshtijeje. Fytyra e saj më shëmbëllente me dikë. Se ku e kisha



parë një fytyrë të ngjashme. Edhe fjalët e saj të thjeshta po më nguleshin në kokë. Një fytyrë e ngjashme...

Dhe ndërsa po mendohesha për t'u kujtuar me cilën më ngjiste, befas kryetari i kooperativës m'u afrua dhe më bije me bërryl.

— Të kujtohet xha Cikoja, ai plaku që e kishte shtëpinë në buzë të lumit?

— Ai që kishte atë kasollen hem me gurë, hem me karthje e pa oxhak, ku fjetëm atëherë, kur hapëm shkollën e parë?

— Po, po ai, e bija e tij është kjo.

— Ashtu!? Manushaqja qënka e bija e xha Cikos! Çudi, çudi, ç'vazjë qënka bërë, mor shoku kryetar. Shpuzë qenka për besë. I lumtë asaj, ju lumtë dhe ju që rritni dhe edukoni një brez të mrekullueshëm.

Dhe mendimet më shkuan larg.

...Ishin vitet e para pas Çlirimit të Atdheut. Këto fshatra ishin jashtëzakonisht të varfëra e të prapambetura. Atë vit sapo kishin marrë tokë nga reforma agrare, por frutet e saj ende nuk i kishin vjelë. Njëherë kishim ardhur si ekip në këto anë. Do të hapnim shkollën e parë dhe bridhnim fshat më fshat që të siguronim dërgimin e fëmijëve. Disa na kuptonin, ca s'na e vinin veshin fare, bile as që shtroheshin në muhabet. Nuk dinim nga t'ja mbanim. Ata që na përkrahnin qenë të paktë, por shkolla duhej hapur. Në një prej këtyre ditëve, ashtu i lodhur siç isha, po udhëtoja me hapa të ngadalshme buzë lumit të fshatit. Kur pa pritur në zall shikoj diçka që po lëvizte midis shkurreve. «Ç'të jetë? — thashë me vete. — Ndonjë kafshë e egër. Ju afrova. Po për çudi, midis gjetheve të shkurreve pashë një fytyrë njeriu. I dola përpara dhe shtanga. Ishte një vajzë një dhjetë-dymbëdhjetë vjeçe. Edhe ajo që ngurosur e po më vështronte me sy të turbullt. Në duar i dridhej një bucelë. Iu afrova, ajo u praps.

— Pse ke frikë moj voglushe? — e pyeta. Mos u tremb, xhaxhi të do fort, — i thashë me ëmbëlsi.

Nuk m'u përgjigj. Vajza e ngurosur me bucelen në duar më vështronte me frikë. Po edhe pamja e saj që me të vërtetë e egër. Flokët e gjata i binin mbi shpatullat. Trupin ia mbulononte një gjysmë fustani apo këmishë ushtarake.

— Më jep pak ujë — i thashë.

Në fillim nguroi, pastaj më zgjati bucelën. E ngrita dhe piva me etje. Kur ia ktheva bucelën, m'u duk se bëri buzën në gaz. Iku menjëherë, gati duke rendur.



Mora përsëri udhën e pas pak arrita në fshat. Përpara një kasolleje gjeta shokun tim, i cili po bisedonte me ca fshatarë. U përhëndetëm dhe drodhëm nga një cigare, por pa e mbaruar cigaren, ai më i moshuari, një burrë i thijnjur, i thatë e pak i kërrusur na mori në shtëpinë e tij.

Nuk dinte ç'të na bënte. Ishte i gëzuar e krenar që i kishim vajtur mysafirë në shtëpi. Ndenjëm gjer vonë atë natë me muhabet. Gjithshka na dukej se shkonte për bukuri dhe shkolla do të hapej, se vështirësitë po i kapërcenim. I zoti i shtëpisë na e kishte dhënë fjalën se të dy djemtë do t'i niste, ndërsa vajzën...

— Edhe vajzën do ta çosh në shkollë, pse të mos e çosh? — i thamë ne, — të hapë sytë, të bëhet njeri.

— E ç'i duhet shkolla vajzës mor djem, — më tha ai.  
— Djemtë, hajde, po vajzën qysh ta le?

M'u duk se në atë çast diçka e shtrëngonte në fytyrë, diçka i rëndonte mbi supet.

Duhej t'ia nisnim nga fillimi. Ai s'po vendoste, lëkundej, por në qoftë se ne do ta linim të mos e dërgonte vajzën në shkollë, do të na shturej gardhi. Jo, ai duhet të bindej, xha Cikoja ishte njeriu i ynë dhe ai duhej të hiqte rrugën e pari, se kishte zë në fshat. Ai pat qënë njeriu më i lidhur me luftën, ai s'kursente asgjë për Partinë dhe për pushtetin popullor.

— Djemtë dhe vajzat i ka njëlloj Partia — i thashë unë.  
— Luftën e bëmë bashkë, Shqipërinë po e ndërtojmë bashkë. Bashkë do të vemë edhe nëpër shkolla. Iku koha kur vajzat i mbanin brenda katër mureve. Ato i fituan të drejtat e tyre me gjak e sakrifica, shoku Ciko.

Plaku ra në mendime të tilla. Ramë të flinim, por ai s'kishte gjumë. U ngrit disa herë dhe vinte rrotull nëpër kasollen e ndriçuar nga zjarri që vazhdonte të ishte i ndezur. Në mëngjes na përcolli me përzemërsi, por fjalën s'na e dha. As ne nuk ngulmuam më. E lamë të mendohej vetë.

Pas disa ditësh shkolla u hap dhe vajza e xha Cikos erdhi në shkollë. Por plaku nuk doli fare nga shtëpia. Friinte ulur te gardhi e pinte duhan, herë pas here ngrinte bucelën e lagte gojën me ujë. Shikimin s'e hiqte që poshtë nga zalli, përtej lumit, tek ajo ndërtesë e vogël e lyster me gëlqere. Ai rrinte si mbi gjëmba. Shqetësohej për vajzën. Kur u kthye e bija, plaku u step, nuk e kuptonte ç'që ai gëzim që kishte ajo. Abetaren e fletoret i shtrëngonte me të dy duart. Po bëhej gati t'i hidhej të jatit për qafe nga gëzimi, por kur pa fytyrën e tij të ngrysur, u step. Po si kur t'i



thoshte «Mjaft, flaki ato karta që ke në duar?!» Vajza i shtrëngoi edhe më fort librin e fletoren që i dukeshin me të çmuara. Kur ia pat dhënë mësuesi ajo ishte dredhur nga emocioni. Befas i ati ia mori librin, e vështrroi me habi, tundi kokën dhe ia ktheu me një rënkim të lehtë, por që vajzës iu duk sikur i tha: «Për hair të goftë».

\*  
\*   \*  
\*

...Përsëri po më del përpara syve ajo vajza dhjetëvjeçare që më pat dhënë ujë me bucelë. Një gëzim i papërbajtur më kishte përfshirë. Po si mund të mos të të rrahë zemra për këta njerëz që rrit dhe edukon Partia, për këtë vajzë kaq të shkathët, kaq revolucionare, nga e cila duhet të merrnin shembull edhe burrat.

Debatet vazhdonin në sallë dhe unë po i ndiqnja akoma më me interesim. Dulja që bërë i kuq në fytyrë dhe nuk e mbante vendi; duart i lëviste me nervozizëm. Manushaqja i kishte propozuar të këmbenin tokat. «Hej drej, thoshte ai. Ç'më ndezi belaja me këtë vajzën e Cikos».

Asnjë nga brigada e tij nuk i doli krahë Dules. Të gjithë ishin të ndërgjegjshëm se Manushaqja kishte të drejtë.

Dulja shtrëngoi dhëmbët, ngrit kokën e ndeshi shikimin e Fates, një i ri nga të brigadës së tij. Fateja po matej të ngrihej. Befas, një shkëndi shprese i ngriti Dules. Zgjati kokën përpara.

— Ma jepni fjalën, kam nja dy llafe edhe unë — tha Fateja.

— Qetësi shokë, — thirri kryetari i kooperativës.

— Që ta themi troç, — ia nisi Fateja — brigada jonë e ka qullalur fare këtë vit, more vëllezër, ç'kam bërë unë? 200 norma gjithsej. Ama si unë ka edhe të tjerë. Turp është, turp sa s'ka ku të vejë. Po tani s'duhet të ecim më kështu. Manushaqja ka të drejtë. Nuk e ka fajin toka jo, po e kemi ne. Populli thotë: «S'ka tokë të keqe, po ka bujq të këqinj.» Ne të brigadës së tretë kemi qenë bujq të këqinj. Kjo është e vërtetë. Brigadieri ynë, shoku Dule, ka lejuar të shtuaret disiplina, nuk kërkon llogari, s'ka organizim, sepse ai edhe vetë nuk është i lidhur me punën. Prandaj ta shikojë veten si në pasqyrë, të pranojë kritikën që i bëhen dhe të bëjë kthesë. Shoqja Manushaqe dhe shokët e tjerë na



dhanë një mësim të mirë ne anëtarëve të brigadës së tretë.  
— Është e para herë që flet kaq lirshëm ky Fateja. —  
më thotë në vesh sekretari i Partisë.

— Dhe më duket se i ra problemit në kokë.

— Vërtet ashtu është, po kushedi sa vështirë e ka patur,  
sa luftë ka bërë me vetveten.

— Në raste të tilla njerëzit duhet të bëjnë ballafaqim  
me ndërgjegjen, ja kështu siç e bëri Fateja.

— Me leje? — u ngrit një djalë nga fundi i sallës.

— Folë, Nesip!

— Unë jam në një mendje me Faten, sepse ai foli ashtu  
siç kisha ndërmend të flisja edhe vetë. Po unë dua të  
shtoj edhe diçka, Dulja ka edhe një të metë tjetër. Kur bëjmë  
ndonjë propozim ne në brigadë, na e hedh poshtë. Ja  
për shembull, kur erdhi puna për të hapur kanalën e ujit  
ne i thamë ta bëjmë aksion të rinisë, kurse ai na tha:  
«Prisni, të na vijë forca nga brigadat e tjera, pastaj t'ia  
nisim». Kështu që brigadieri na e preu hovin. Kjo ndodhi  
edhe me transportimin e plehut. Mbetëm apo s'mbetëm në  
fund ne? Gatitem tezgat, koshat, po prapë ai na thoshte:  
«Prisni të kullojë dheu». Unë e kam kritikuar edhe në  
mbledhjen e brigadës, po nuk më dëgjoi.

Dulja turfullonte nga zemërimi.

— A janë të vërteta këto që thonë djemtë, o Dule? —  
pyeti Ridvani.

— Sa për punët e bujqësisë, unë ato i di më mirë se  
Fateja e se sa Nesipi dhe të mos i tregojnë babajt arat ata.  
Po hajde, i riu si veriu. Po fundi fundit, o shokë, në mos  
u pëlqej si brigadier hiqmëni ore, përfundoi ai, dhe u ul  
akoma më i zemëruar.

Në sallë kishte rënë qetësi. Po me sa dukej kësaj çështje  
i duhej futur më thellë. E sa më thellë t'i futeshin  
aq më shumë çështje do të delnin.

U ngrit kryetari i kooperativës, e tha:

— Këtë problem mendoj ta shtrojmë për diskutim në  
mbledhjen e brigadës. Jeni dakord?

— Doemos, dhe ne kështu themi. Atje le t'i shoshitin  
punët — u hodh e tha Ridvani. — Kësaj brigade i do bërë  
çareja. Ama edhe ju shokë të kryesisë, fajin me torbë e  
kini. Ç'kini bërë ju? Ku kini qenë? Pse e kini lënë këtë  
brigadë të mbetet kaq prapa? Në s'duhet të kemi asnjë  
brigadë, asnjë skuadër të prapambetur në kooperativën tonë.  
Kështu na mëson Partia, o shokë.



Zemërimi iu ul pak Dules. Propozimi i kryetarit i solli një farë ngushëllimi, një farë shprese.

— Atëherë kështu, — shtoi kryetari. Nesër në mbledhjen e brigadës së tretë do të vinë përfaqësues të brigadave të tjera dhe ne të kryesisë.

Kur po dilnin kooperativistët nga salla, Manushaqja diçka po bisedonte me Ridvanin, por kur ktheu kokën ndeshi shikimin tim dhe u skuq. Pa vetëdije bëra disa hapa përpara e i shtrëngova dorën dhe i thashë:

— Të lumtë Manushaqe! Je bërë një shembull i ndritur për të gjithë kooperativën.

Ajo nuk fliste, vetëm më shikonte e nënqeshte.

E në ato çaste mendja më fluturoi përsëri larg, në ato vite, në atë buzëlumi, tek ajo vogëlushja e ndrojtur që më dha ujë me bucelë, atë ditë vjeshte.



## BALLË PËR BALLË ARMIKUT

Skicë

Era fëshfërin nëpër gjethet e dushkut dhe kufitar Ilia hedh andej një vështrim të kujdesshëm. Ai është roje. «Vështrimi duhet mbajtur mprehur në çdo çast, mendonte, armiku është dinak e mund të shfrytëzojë shushurimën e erës, dendësinë e pyllit, çdo gjë rreth e rrotull.»

Kërcitja e lehtë e thyerjes së një shkarpe erdhi në veshin e tij. Papritmas duket, fare pranë, një burrë shtat lartë që mbante në dorë një automatik. Tre të tjerë edhe ata të armatosur, dy me pushkë dhe një me automatik e ndjekin pas.

Vështrimin e hedhin të shpejtë, të trembur.

«Armiq» tha ushtari me vete dhe i dha sinjalin nënrepartit.

«Sa të vijnë shokët duhen gozhduar në vend, mendoj kufitari me vete. Po si, në ç'mënyrë? Ata janë midis dushqeve Po t'u thërres «ndal», do të fshihen menjëherë. Pylli është i dendur, terreni i thyer, kufiri afër, natë po vjen dhe mundet të na shpëtojnë. Si të veprojmë? Po t'i lë të dalin nga pylli mund të marrin drejtimin e rrëpirës. Atje nuk e shoh mirë një copë vend. Jo, nuk do t'i lejoj të kalojnë andej. Si të bëjmë? Edhe dhjetë hapa dhe dalin nga dushku. Shpejt Ilia, vendos» — i tha vetes.

Një zë i brendshëm i kumbon në vesh. Ai nuk është zë, por kushtim për beteja, gjokshapur, ballë për ballë armikut. Në jetën e tij njëzetvjeçare nuk e ka ndjerë zemrën t'i rrahë me kaq vrull. Del shpejt nga pozicioni, dhe lëshon si plumb atë fjalë të rreptë ushtari: «Ndal!»

Fjala gjëmon dhe bie mbi armiqtë si rrufe. Pastaj të tjera «rrufe» derdhen mbi ta, njëra me përvëluese se tjetra: «Armët përdhe!», «Mos lëviz».

Ata shtangen, ngrijnë në vend. Gryka e mitralozit u





duket si grykë topi. Armët i hodhën përdhe, duart i ngritën lart.

Shokët vonohen. Kështu i duket Ilias. «Sikur të mos e kenë dëgjuar sinjalin»? Mendon dhe i vjen turp që mendon kështu. Le të jenë ata katër dhe unë një. Ushtari shqiptar duhet të luftojë me shumë armiq, t'i asgjësojë ata dhe të jetë kurdoherë i gatshëm për të asgjësuar armiq të tjerë. Ndjen se forcat po i shumëfishohen e i duket sikur ato i burojnë nga tabani i tokës, nga toka shqiptare, që ka lindur vetëm heronj dhe heroina.

Nga ata e ndajnë disa hapa: E kalon vështrimin vetëtimthi nga njëri tek tjetri. Fytyra ngjyrë dheu. Qëndrojnë të heshtur si kufoma. Para se të hidhnin këmbët e tyre mbi truallin shqiptar, qenë betuar se do të vepronin si trimat, por... secili mundohet të tregohet sa më i bindur, për t'i shpëtuar breshërisë së mitralozit.

I pari duket sheshit se është kapobanda. Ai e vështron ushtar Ilian me një palë sy të vegjël si të gjarpërit dhe zien përbrenda. Para fytyrës së tij zgjatet një degë dushku. E nduk me dhëmbë dhe e bluan me nervozizëm. Ai e sheh se ushtari është vetëm dhe i vjen të hajë veten se si ra në kurth dhe u dorëzua në mënyrë kaq të turpshme. Kufitari i tregon në çast grykën e mitralozit. Kapobanda e kupton se çdo të thotë një veprim i tillë: «Asnjë lëvizje më tepër!». Shokët i ka në brinjë. U hedh atyre nga një gjysmë vështrimi. Të gjithë i duken të shpëlarë. Gojë e vartësve të tij janë kyçur e duket sikur nuk do të hapen kurrë. Vetëm sytë i kthejnë me frikë, me dridhma, nga ushtari shqiptar, i patundur, trim e syshqiponjë.

I dyti pas kapobandës, me sy të zmadhuar, kohë pas kohe e vështron kufitarin me ndruajtje. Sytë e tij ndeshin në sytë e mprehtë të Ilias. Atje ai sheh urrejtjen e thellë të ushtarit shqiptar për armiqtë, një urrejtje përvëluese.

I treti, një stërfyell i gjatë, me kokë të vogël vezake. I mban sytë përdhe. Edhe ai e kthen fytyrën nga ushtari, një fytyrë me lëkurë të ashpër e të murme. Këtë e bën me paramendim, se mos kufitari dyshon në të e i lëshon ndonjë breshëri mitralozit. Atje i mbërthen sytë e tij të mëdhenj e të turbullt. Mornica i shkojnë nëpër trup, në fyt ndien një lëmsh, një gulçimë. Kapela i bie në tokë e pada-shur e shkel dhe e leros me baltë.

I katërti, ka ngjeshur një gjerdan plot e përplot me fishkë që të lënë përshtypjen se ai do të jetë më trim midis tyre.

Por shprehja e fytyrës, qëndrimi i tij i rraskapitur e tradhtojnë. Është i dërmuar shpirtërisht. Mjekra i varet mbi gjoks. Jetën e tij e sheh të varur në një fije peri, në grykën e mitralozit. Ai nis të buzëqeshë duke menduar se kështu mund të zbutë pakëz atë vështrim të rreptë të kufitarit.

Syrit të Ilias nuk i shpëton asgjë. Në fytyrën e armikut ai vë re një skërmitje të shëmtuar, një ngërdheshje që nxjerr në shesh një qenie dhelparake. Por ajo buzëqeshje e rreme u zhduk shpejt dhe vendin e saj e zuri frika, ku vështrimi i tij ndeshi përsëri në vështrimin përvëlues e kup-timplotë të ushtarit që flet vetë: «Edhe ti je një nepërkë e helmatisur e që pret rastin më të volitshëm të kafshosh me ata dhëmbët e tu plot helm, por unë të kam zënë për gryke dhe po e lëvize pak bishtin, të shtypa kokën...»

Erdhën edhe kufitarët e tjerë. Armiqtë mbetën të mbërthyer në darën e vigjilencës së ushtarit të popullit, të kufitarëve tanë heroikë.



## XHA SULOJA DHE PARTIZANËT

*Skicë*

Ne ishim shtruar dhe po hanim me oreks të madh bukën dhe qepët që na kishin sjellë fshatarët. Midis tyre ishte edhe xha Sulua, një burrë me rroba shajaku e një palë opinga lëkure derri. Në krahë i varej një maliher i shkurtër e në bel gjerdani me fışhekë.

Unë e shihnja me kureshtje xha Sulon, sepse më ngjiste me babanë tim. Dhe ai e vuri re këtë gjë dhe ia nisëm bisedës.

— Sa vjeç je mor bir, më tha, duke vënë buzën në gaz.

— Këtë muaj mbush të 18-tat xhaxha, iu përgjegja.

— I ri qënke... Edhe im bir, ai i mesmi, 18 vjeç është.

Kur i vura patickën e gjatë në krah qyta i arrinte në tokë.

— Ku ndodhet ai tashti — thashë unë.

— Në brigadën e 7-të sulmuese, në zonën e Beratit. E quajnë Orhan. Po të të bjerë rasti ta takosh jepi të fala nga babai...

Në këto fjalë pranë nesh erdhi Ahmeti, komandanti i kompanisë sonë.

— Të faleminderit, xha Sulo, për bukën që na prure — i tha ai.

— E kemi për detyrë, more bir. Ju kemi djemtë tanë. A s'luftoni për ne? — ia ktheu ai.

Komandanti i kompanisë kishte një aftësi të tillë që komunikonte shpejt me njerëzit. Duke biseduar për luftën ai i tha xha Sulos se kishte të ngjarë që gjermanët dhe ballistët mund të sulmonin përsëri. Mirëpo nga ana e Prishtës kompania i kishte krahët të zbuluara.

— Si thua, xha Sulo, — përfundoi komandanti, a do të ketë mundësi që nga fshati juaj të dalë njësitë e armatosur nga ajo anë për nja dy tre ditë?

— Llaf është ai — ia ktheu shpejt e shpejt xha Sulua. Ne u bëmë gati të vinim, që kur dëgjuam luftën tuaj, por kur pamë se i vutë përpara, menduam se nuk ishte nevoja.



— Të faleminderit, xha Sulo, — i tha Ahmeti dhe i zgjati kutinë e duhanit.

— Thua të marrin përsëri guxim të paudhët të ngjiten këtyre majave? — pyeti plaku pas një farë heshtjeje.

— Ashtu na e pret mendja, xha Sulo.

— Ke të drejtë... Hasmi nuk fle, është i pabesë...

— Po deshët, xha Sulo, ju jap dhe disa nga tanët.

— Partizanë?

— Po, po, partizanë, t'i keni për ndihmë.

Xha Sulua e nguli shikimin te unë me një buzëqeshje të ëmbël. Të them të drejtën, ma kishte qejfi të veja më të. Ai sikur i bleu mendimet e mia.

— Nuk e ke keq, shoku komandant. Ja më jep edhe këtë partizanin e vogël. Disa fjalë këmbeva me të, por më hyri në zemër.

— Qoftë e bërë, o xha Sulo, le të vijë edhe ai.

Nga partizanët e tjerë erdhën Avniu dhe Qaniu.

Qysh atë mbasdite, së bashku me xha Sulon dhe 12 fshatarë të tjerë, u gjendëm në faqen e shkëmbit të Sherit. U miqësova shpejt me ta. Një e quanin Isuf, një tjetër Qenan, të gjithëve ua mësova emrat brenda ditës.

Xha Sulua së bashku me dy bashkëfshatarët e tij hipën në një bregore për të parë vendin. Kur u kthye, m'u drejtua mua:

— Si thua ti, bir, të vijnë ata të mallkuar këtej?

— Për çdo gjë duhet të jemi gati xhaxha.

U mbështeta pas një dëllinje dhe po rrinja i heshtur.

Dita kishte hapur, një ditë dimri e vrejtur dhe gati për të rënë borë.

Ndërkaq xha Sulua hoqi maliherin nga supi dhe bërtiti me zë të lartë:

— Kush jeni ju atje?

— U ngrita në këmbë. Pas dëllinjave pashë tre njerëz të armatosur që vinin drejt nesh të shpërndarë.

— Gjermanët xha Sulo! — thirra dhe u shtriva pas një guri të madh.

Xha Sulua aty për aty zuri pozicionin, qëlloi i pari.

Dy breshëri automatiku u derdhën mbi ne.

— Ulu, xha Sulo, i thashë dhe e zura për gunë.

— Po ti ç'bën kështu?

— Ulu, xha Sulo, plumbi nuk pyet.

Pa zënë vend mirë xha Sulua, një kollonë e gjatë me gjermanë po afrohej drejt nesh.





Syrin në shinjestër



— Kini mendjen, qëlloni drejt e në shenjë, mos i harxho-  
ni kot fishekët na tha Qenani.

Gjermanët zunë vend te një brinjë.

— Dëgjoni, tha xha Sulua — ata të mallkuar do të na sul-  
mojnë me zjarr të fortë. Kur të afrohen do të bëjmë sikur  
ikim. Që këtej do të vemë të zëmë vend te shpellat e mëdha.

Pa mbaruar mirë fjalën xha Sulua, një mitraloz gjerman  
filloi të villte zjarr pa pushim mbi pozicionet tona. Gjermanët  
u hodhën në sulm. Ne i pritëm ashtu si duhej, por ata ishin  
shumë dhe ecnin me shpejtësi drejt pozicioneve tona.

— Shokë, erdhi koha që të zëmë shpellat. Hajde, Avni,  
Qani, nisuni ju të parët... Urdhëroi xha Sulua.

Arritem në vendin e duhur pa asnjë humbje. Vetëm Qa-  
niu kishte marrë një plagë të lehtë. Larg pozicioneve të para  
ra një heshtje e madhe. Befas në qafë dolën dy ballistë. Ata  
u ulën dhe po vrojtonin me kujdes të madh. Më vonë dolën  
të tjerë ballistë e gjermanë së bashku. Në drejtimin e shpe-  
llave nuk u nis e gjithë kollona, po vetëm tre vetë, dy gjer-  
manë dhe një ballist. Nuk i qëlluam megjithëse patrulla  
afrohej gjithnjë e më shumë. Xha Sulua i bëri me shenjë  
Avniut dhe Qaniut dhe hynë në shpellë. Zunë një shteg të  
ngushtë. Aty mund të kalohej vetëm për një, se qe rrugë  
dhish. Kur mbriti ballisti, Avniu e kapi dhe i zuri gojën me  
dorë, Qaniu i futi thikën në gjoks, kështu u veprua edhe me  
gjermanët. Kjo ndodhi kaq shpejt sa u mahnita. Ata të kollo-  
nës s'kuptuan asgjë. Duke kujtuar se patrulla e tyre vazhdon-  
te rrugën, ecnin të sigurtë drejt nesh. Ne qëndronim në  
gadishmëri. Kur mbritën afër qafës sa mund të hidheshin  
granatat e dorës, xha Sulua bërtiti:

— Bjeruni bishave gjakatare!

U bë tym e flakë. Të vrarët rrukulliseshin nëpër rripa  
si trungje. Disa gjermanë shpejtuan të dalin nga qafa dhe u  
drejtuan nga shpella duke u zvaritur rrëshqanthi, po i bëmë  
fërtele me granata te hyrja e shpellës. Befas u organizua një  
grup i ri që i mbronte, dy mitralozë të rëndë. Coprat e pre-  
dhave na rrezikuan sytë. Grupi partizan hodhi bombat e do-  
rës. Gjëmimi e shpërthimi i fuqishëm dëgjohej në ato pllaja,  
por qafa nuk u kalua; në grupin e parë ranë dhe katër gjer-  
manë të tjerë. Kjo ngjarje i egërsoi keq armiqtë dhe filluan  
të na sulmonin nga të gjitha anët. Drejt qafës u nisën njeri  
pas tjetrit grupe-grupe që mbuloreshin me zjarrin e mitra-  
lozëve të rëndë. Vunë në përdorim artilerinë; shpërthime,  
urdhëra në gjuhë të huaj, sokëllima, rënkime.



Pranë kisha xha Sulon. Pa pritur m'u zhduk nga sytë.

— Xha Sulo — thirra unë.

— Jam këtu — m'u përgjigj ai.

Pas pak u afruan bashkë me Avninë. Në duar mbanin gurë të mëdhenj.

— Ç'i doni? — i pyeta i habitur.

— Na u mbaruan fishekët.

E kuptova. I vunë ato mbi shpellë dhe i rrukullisën poshtë. Hodha sytë në gjerdanin tim e pashë se më kishin mbetur akoma tre ballë fishekë.

— Xha Sulo, po na mbarohen fare.

— Me gurë, bjeruni me gurë.

Por gurët nuk ishte e lehtë t'i shkulje. Në këtë kohë xha Sulua thirri:

— Qani, ndiz dëllinjat e prera.

Për një çast mbeta i habitur dhe nuk e kuptoja se përse duhej ky tym, por kjo u sqarua më vonë. Kur tymi dhe flaka mbuluan qafën xha Sulua bërtiti:

— Të gjithë gati për t'u nisur në drejtim të Tendes së Qypit. Bombat gati, djem!

Në këto çaste lugina gjëmoi nga pesë shpërthime të forta.

— Djem, detyrën e kryem, të gjithë pas meje!

U vumë njeri pas tjetrit.

Kur kaluam ato pllaja e mbritëm te vendi i quajtur «Tenda e Qypit», gjermanët dolën në shpellat. Qëlluan me mitraloza të rëndë dhe artileri... Tani ishim larg.



ALTINI

Skicë

Altini ka dy muaj që ka ardhur në fshatin tonë malor. E ëma dhe i ati dolën vullnetarë për të jetuar gjithmonë në fshat. Doni ta njihni familjen e Altinit? Ja, po ju flas për ta. Babi i tij punonte në një ndëmmarrje në qytet si murator i dalluar. E ëma ishte edukatore kopshti. Altini ka edhe një vëlla të vogël, Gazmendin. Gazmendi vete në kopsht. Ata ia çojnë shumë mirë në fshatin tonë. Janë të gëzuar dhe të lumtur. Nuk është zor ta dallosh kënaqësinë e tyre. Edhe shokët e klasës së Altinit u gëzuan kur ai erdhi të mësonte aty. Të nesërmen e mbërritjes në fshat, Altini, i veshur bukur dhe pastër, u nis për në shkollë. Rreth tij filluan të grumbulloheshin jo vetëm moshatarët e tij, por edhe ata të klasave më të larta. Fëmijët i bënë pyetje: A e njihnte atë ose këtë futbollist, ç'film kishte parë kohët e fundit e të tjera. Ai u përgjigjej dhe për ato që s'dinte ngrinte supet. Agroni, një djalë pak më i shkurtër se Altini, topolak e i shkathët, i tha:

— A di të luash futboll ti, Altin?

— Si s'di, — u përgjegj ai. — Unë kam bërë pjesë në rrethin e futbollistëve të vegjël të shtëpisë së pionierit.

— Oho, oho, sa mirë, tani po të duan le të na mundin klasat e tjera!

Mësuesja e vuri në një bankë me Agronin. Kur pyeste mësuesja, ai fliste shkurt dhe jepte shpjegime të plota e të qarta. Mësuesja dhe nxënësit e kuptuan se Altini ishte nxënës i mirë. Në klasë kishte edhe shumë nxënës e nxënese të tjera të mira dhe Altini mësonte shumë prej tyre. Edhe ata mësonin prej tij. Të gjithë e ndihmonin njëri-tjetrin me dashamirësi. Altini kishte bërë edhe një album me pamje nga vendi ynë.

— Edhe unë do të bëj një të tillë, — tha Mirjana.



— Edhe ne, — u hodhën e thanë nxënësit e tjerë.

Altini u njoh me jetën e fshatit. Ai u miqësua me të gjithë shokët, por më tepër u miqësua me Agronin dhe një shok tjetër nga klasa e gjashtë, me Dritanin. Të tre merreshin vesh shumë mirë. Një të diel vajtën të kullonin shqerkat në një mezhde sipër fshatit. Atje ishte mrekulli. Kishte bar të mirë dhe të dendur. Lëndina ishte rrethuar nga të gjitha anët me shelgje e shkurre. Pranë gjarpëronte një përrua i rrëmbyeshëm. Kishin marrë me vete edhe librat. Fëmijët luajtën me top dhe u kënaqën. U morën më lodra dhe harruan se një keç u kishte ikur. Matanë ishte një kodër plot më dushqe të dendura: keckës i pëlqenin më tepër gjethet, kurse shqerrave bari.

— Ti, Altin, mos u mërzi; sa të vemë ta kërkojmë dhe do të vijmë shpejt, apo ke frikë? — i tha Dritani.

— Jo, — tha ai. — Po këtë fjalë e nxorri si me gjysmë zëri.

Ata u larguan. Altinit i hyri frikë e madhe.

«Ç'bëra unë që u thashë atyre shkoni! Pse nuk u thashë se doja të veja edhe unë me ta? Të kisha shkuar me ata do të ishte më mirë. Ja, ja, ku dolën ata, ehu, sa larg paskan shkuar!» — Befas ai dëgjoi zërin e Agronit që thërri-ste:

— Kece, kece! Kece, kece!

Pastaj asgjë s'u ndie. Qetësi. «Po unë, — tha me vete. — Këtu është pyll... Po sikur të dalë nga pylli ndonjë ujk?» U dëgjua kënga e laureshës. Bukur këndonte edhe bilbili. Po sa para bënte kënga përpara frikës së tij! Meloditë e bukura të zogjve formonin një kor të mrekullueshëm, sikur të donin t'ia hiqnin pak mërzinë. Shelgjet e të dy anëve të lumit përkuleshin nga era, sikur takoheshin me njeri-tjetrin. U ndie një fërshëllimë e fortë. Altinit sa nuk i ngriu gjaku. Prej andej dolën ca pëllumba të egër. Si i rrihte zemra! Pandehu se mund të ishte ndonjë egërsirë. Ai kishte dëgjuar shumë gjëra për ato, ndaj dhe ua kishte frikë. U dëgjua një zë që thirri:

— O Altin, ore!

— O, oooo-o — u përgjigj Altini.

— E gjetëm, o, e gjetëm dhe ja, tani do të vijmë.

«Ou, sa larg paskan shkuar! Ç'bëra unë që thirra! Po sikur të më dëgjojë ndonjë nga ato kafshët dhe tani të më vijë? Agroni kishte hipur majë një shkëmbi, Dritani, që ishte në krahun tjetër, ishte shumë larg tij. Po këta si nuk kanë frikë?» — tha me vete Altini.



— Thuaj të drejtën Altin, a u trembe? — tha Dritani që sapo erdhi.

— Jo, nuk u tremba.

— Hë, kujt i thua, ti je zverdhur si ftua; s'ka gjë, do të mësohesh.

Kishte vajtur dreka dhe dielli të digjte. Ishin pranë lumit. Kur je pranë tij ai të fton vetë.

— A lahemi? — tha Dritani.

— Jo. — tha Altini. Unë s'jam larë ndonjëherë, pastaj ujët është i ftohtë, mua më flet mami, pa mirë.

— Oho, sa i ngrohtë! — tha Agroni, që u zhyt i pari. Altini nuk u zhvesh, por i vështronte. Veç kishte shumë dëshirë të lahej. Futi dorën dhe pa ujin. Filloi të zhvishej me përtesë dhe u zhyt me frikë. Ata u lanë dhe u shtrinë mbi bar. I kishte marrë uria dhe shtruan të hanin bukë. Sa u kënaqën atë ditë në ajrin e pastër! Altini ishte më i kënaqur se dy të tjerët.

Herët e tjera ata nuk kishin shkuar kaq larg dhe nuk kishin provuar kaq emocione sa atë ditë. Altini u kthye i gëzuar, se kishte mësuar shumë gjëra të reja në fshat, madje kishte filluar të mësonte edhe t'u hipte kuajve pa samar.

— A vihemi në garë? — i kishte thënë Agroni.

— Do të vihemi, por jo tani — i qe përgjigjur Altini, të mësohem edhe unë ashtu siç je mësuar ti, pastaj po deshe e provojmë.

Ato ditë klasat ishin përfshirë në aksion për të mbledhur sa më shumë plehun e pyllit, humusin. Një ditë klasa e tyre shkoi në pyll së bashku me të tjerat. Ishte një ditë e kthjellët maji. Fëmijët u gëzuan së tepërmi. Mësuesi u kishte folur shumë nxënësve për të mirat e pyllit, për bukurinë e tij. Aksionin Altini e priti mirë. E kush ishte ai që nuk e priste mirë? Altini kurrë nuk kishte shkelur në pyll. Për humusin e pyllit atij i kishte treguar edhe mami. Ajo kishte punuar së bashku me shoqet në pyll. Atë ditë Altini me shokët morën veglat në krah, vunë nëpër çanta ushqimin e drekës dhe u nisën. Rruga për në pyll ishte e përpjetë. Kalonte në ca kodra me shkëmbinj gëlqerorë. Pastaj dilte në një livadh të vogël. Në pyll ishte një rrugë nja njëqind metra e drejtë, në të dy anët me pisha të larta. Deri këtu vinin makinat dhe merrnin lëndë druri.

— Ja, ja ketri — i tha Genci Altinit dhe po qëllonte me gurë, ndërsa ketri hidhej sa në një degë në degën tjetër si akrobat. Altini sa e pa vrapoi dhe po e qëllonte me boçe pishe.

— Të ha ketri? — i tha ai Gencit.



Të gjithë sa e dëgjuan qeshën me zë të lartë.

— Si ore të ha ketri! Ç'e bëre ti ketrin? Ketri ha vetëm stika e gjethe.

Ketri vazhdonte të kërcente me shkathtësi sa në një pishë në tjetrën. Fëmijët qeshnin e bërtisnin sa oshëtinte pylli.

— Po arrinj ka në pyll? — pyeste Altini shokët dhe ata habiteshin e qeshnin.

— Ka ndonjë ari, por janë shumë, shumë të rrallë, aq sa asnjëri nga ne nuk ka parë, ka që kuri, edhe të tjerët nuk kanë parë. Kemi dëgjuar për të më shumë në përrallat. Altini vërtiste sytë sa andej këtej. Ai kishte dëgjuar shumë gjëra për pyllin dhe nuk i kujtoheshin të gjitha. Kishte dëgjuar se në pyll kishte edhe kafshë të frikshme, por tani nuk ndjente frikë, veç kishte kureshtje t'i shikonte në çdo hap e bile edhe t'i përshëndeste. I qeshej me vete. I kujtohej kur humbi kecka. Ah, ç'ishte trembur më kot. Tani ai shikonte një pyll të bukur, të këndshëm sidomos, kur e vështronte nga shkëmbi. Mbritën tek drurët e ahut me degë të mëdha. Nga larg vinte jehona e sopatave të druvarëve.

U ngritën të gjithë. Mësuesi i udhëzoi se si duhej grumbulluar plehu. Fëmijët filluan të punonin me gjallëri. 'Sa shumë mblidhnin! I pastronin një herë fletët, pastaj rëmonin me shata e bela; beli futej për mrekulli në tokë. Plehu i zi, si trofë, dilte në sipërfaqe dhe lëshonte avull të ngrohtë.

— Hë, Agron, mblidhe mirë — tha Altini — edhe një lopatë pleh na vlen!

— Më fal, Altin, — tha Agroni — m'u duk sikur s'kishte fare. Në çdo hije ahu edhe pishe kishte nga një kopicë të madhe pleh. Kafsharët e kooperativës në ca thasë ngarkonin dhe e çonin nëpër ngastrat, në fushë. Puna i kishte rrëmbyer shumë fëmijët. Ata shpejtonin të grumbullonin sa më shumë që të ishte e mundur. Altinit po i dilte edhe më tepër frika, s'po e mundonte si më parë. Ai ishte vënë në garë me shokët. Po kërkonte vende të reja plehu. U largua pak nga ata. Ishte një ah pak i madh. Atje Altini gjeti pleh dhe po punonte vetë. Pas pak tek grupi i nxënësve u afrua mësuesi.

— Ku është Altini? — pyeti ai.

— Këtu është, mësues — tha Genci.

— Altin! — thirri ai.

— O, Altin — thërret fort Genci.



— O, Altin, o! — përgjigjet jehona e zërit. Pikërisht kjo jehonë po i pëlqen më tepër atij, ndaj edhe pse e dëgjon-te nuk përgjigjej. Pasi dëgjoji edhe dy tri jehona të forta — ai u përgjegj.

— Ja, erdha, o, erdha!

— Shpejt, shpejt, — u dëgjua një zë tjetër.

Mbas pak mbriti Altini.

— Ku ishe? — i thirri mësuesi.

— Më tërhoqi një hie ahu, me pleh shumë, mësues — tha ai. Pa shkoni të shikoni sa kam mbledhur. Ah, sa mirë është atje!

Pasi pushuan, fëmijët mblodhën gjethe dhe fletë pemësh për herbariumet e tyre.

U kthyen tepër të gëzuar. Altini njohu gjithçka. Ai u bë mik i ngushtë i pyllit. Dashuria për shokët e për fshatin e bukur socialist atij i rritej nga dita në ditë.



## «BUALLI I KËNETËS» NUK KËNDON MË

(Përshkrim)

Atëhere kur kërbacı dhe mashtrimi e kishin fjalën në vendin tonë, çdo ëndërr dhe dëshirë e popullit mbeteshin si një zhgënjim, si një vagullim i varur në horizontet e kohës dhe të jetës.

E tillë ishte edhe ëndrra e njerëzve rreth kënetës së Maliqit.

Këneta e amullt e kallamave dhe e shavarit, e baltovinës dhe e lëmazhgate, e bunacës dhe e mushkonjave. Ajri i rëndë endej mbi të, raskapitës e mbytës, ashtu si endeshin lundërtarët mbi ujërat e fjetura, në kërkim të jetës. Po, jetën e tyre fshatarët e zbathur dhe verdhacukë e kërkonin në atë kënetë që u jepte vetëm malarjen dhe zymtinë. Ata vozitnin me lundrat dhe këndonin këngën e tyre monotone të mërzisë, të skamjes dhe të dëshpërimit. Vozitnin endacakë dhe këndonin me kadenca të zvarritura, jo nga gëzimi, por nga dhimbja, mos vallë këtë dhimbje e shuanin në ato nota të pakta të melodisë së zgjatur.

Kënga zgjatej, përhapej nëpër kënetë dhe përzihej me buçimën e saj që vinte prej thellësive. Buçima vinte nga larg, dhe njerëzit thoshnin «Këndon bualli i kënetës».

Ushkante kënetat dhe u përgjigjej me ashpërsi të pamëshirshme ëndrrave dhe kërkesave të njerëzve.

Gjer kur do të vazhdonte kjo buçimë? Kush do ta ndalte? Kush do ta shuante atë?

Vetëm krismat e pushkëve, nga të cilat do të lindnin këngë të reja: këngët e shpresës, të kryengritjes, të revolucionit! Dhe këto këngë u ngritën fuqishëm që nga ajo ditë e shënuar e 8 Nëntorit 1941, kur në një shtëpi të thjeshtë të Tiranës u mblodh Kuvendi i Madh që lëshoi kushttrimin shpëtimtar. Këto këngë do të përhapeshin kudo, do të mbytnin rrënkimet e kënetës, do të lartoheshin me tinguj të rinj pas ditës së pavdekshme të lirisë, që do të sillte ditët e reja të jetës.



## Çadrat e barakat e para

Kënetës i erdhi fundi, ashtu si u kishte ardhur fundi gjithë rënkimeve, padrejtësive, shfrytëzimeve.

Kjo ndodhi në majin e 1946-tes, këtu e 30 vjet më parë, në majin e dytë të Çlirimit kur pemët kishin lëshuar gjeth të ri e kishin çelur lule shumëgjyrëshe.

Në atë maj, buzë kënetës u ngritën çadrat e barakat e para, erdhën vullnetarë nga gjithë Shqipëria. Midis tyre ishte dhe një djalë i ri, 15-16-vjeçar, i drojtur, me një vështrim të qetë e të thellë, me një dritë të gjallë në sytë e tij, Bexheti, një, bir fshatari që gjithmonë kishte ëndërruar për tokë dhe për bukë. Ai tregon:

— Erdha bashkë me vullnetarët e parë, për të punuar për tharjen e kënetës. Kisha dëgjuar sa vite më parë, bejlerët dhe tregtarët kishin marrë përsipër gjoja për të tharë kënetën. Por ata nuk bënë gjë. Vetëm vodhën e mbushën xhepat me djersën e popullit dhe e lanë kënetën ashtu siç ishte, të na çante mushkonja dhe të dergjeshin, pa tokë, pranë ujërave të saj të ndotura. Erdhëm plot qejf ne vullnetarët për ta kthyer kënetën në tokë buke, në tokë që do t'u jepej fshatarëve, ku do të ngrihej një fermë, ku do të ndërtoheshin fshatra të reja dhe do të rronim të gëzuar. Prandaj dhe nuk pyesnim për pengesa dhe vështirësi. Të gjithë punonim ditë e natë, luftonim kundër ujërave, pa u tërhequr përpara mungesave. E kishim zor dhe për ujë të pijshëm. Punonim dhe sytë i mbanim hapur kundër armiqve e sabotatorëve, të cilët gjetën këtu vdekjen.

Bexheti, ndonëse nga ajo kohë vrulli dhe ngazëllimi na ndajnë tridhjetë vjet, i ka të freskët dhe të dashur muajt e punës për tharjen e kënetës, i ka të ngrohta mbresat dhe kujtimet e tij, ashtu si i kanë mijëra e mijëra vullnetarë që morën pjesë në këtë aksion të madh, që mobilizoi të moshuar e të rinj. Gazeta «Përpara» e asaj kohe shkruante: «Atje ku punohet për bukën e popullit (Në Maliq brenda një dite 633 vullnetarë në 4431 orë punë gërmojnë e transportojnë lart nga 798 metra kub tokë...)» «Në Maliq kanë punuar 13.394 vullnetarë brenda 5 ditësh. Punimet zgjerohen në kanal, në kantier dhe në gurorë. Populli i nënprefekturave u dërgon vullnetarëve ushqim dhe letra lavdërimi...» «Maliqi do të thahet që sivjet. Ecnitë të shihni si punohet në Maliq. Qindra vullnetarë shtojnë çdo ditë radhët... Përfundimet e punimevet janë të dukshme që tani. Kantieri është kthyer në vatër entuzjazmi dhe pune...»



Kështu punuan, kështu luftuan vullnetarët, të zhytur gjer në brez në ujëra, në baltë, në shi e në zheg, luftuan kundër të ftohtit dhe reaksionit, kundër këlyshëve të bor-gjezisë dhe agjentëve të imperialistëve anglo-amerikanë.

Punëtorët e vullnetarët nga fshati e qyteti, me në krye komunistët, nën dritën e Partisë dhe me besimin e madh në zemrat, ndonëse me pak mjete të mekanizuara, i nënshtruan ujërat, çelën kanalet dhe e drejtuan kënetën në to.

Në dhomën muze të shtëpisë së kulturës të sektorit Drithas, njëri nga sektorët kryesorë të ndërmarrjes bujqëso-re që shtrihet në tokat që mbulonte dikur kënetat midis materialeve të tjera është një fotografi e madhe që paraqet udhëheqësin e Partisë dhe të popullit, shokun Enver Hoxha, duke hapur portat për derdhjen e ujërave në kanal, me 12 tetor 1947.

Aksioni i tharjes së kënetës u kurorëzua me fitore. Tokat e para që do të jepnin bukën e popullit dhe prodhime të tjera filluan të dalin nga ujërat, të bëhen prodhuese.

### Një jetë e re lulëzoi

Pas kësaj u desh akoma punë dhe djersë. U kryen punimet e fazës së dytë të tharjes së kënetës, u punua për kullimin e tokave, për sistemimin e tyre.

Banorët e parë filluan të vijnë në fushat e Maliqit. Njerëz të punës nga të gjitha anët e rrethit dhe nga rrethe të tjera. Ata vinin plot besim dhe vullnet për të punuar, për ta bërë tokën pjellore, për t'i dhënë atdheut drithëra, fruta, perime, qumësht, mish, gjalpë.

Në marsin e vitit 1951 erdhi nga Gjobabasi edhe xha Çerçizi me familjen e tij. Vetë i nëntë. Kishte gjashtë fëmijë të vegjël. Disa i kishte futur në koshat ngarkuar mushkave që i kishte marrë hua nga shokët. Djalin më të vogël dy muajsh, e mbante e ëma të mbështjellë me pelena. Çerçizi ishte një mjeshtër i zoti. Dikur kishte punuar nëpër dyert e botës, por tani vinte për të ndërtuar shtëpitë e punëtorëve të fermës, në fushat e reja të Maliqit.

Vendi ishte atëhere i zhveshur. Vjeshtën e kaluar ishte mbjellë gruri i parë. Atë pranverë do të mbillej panxhar sheqeri dhe bimë të tjera. Çdo gjë sapo fillonte. Njerëzve u mungonin shumë gjëra.

Ja ç'tregon shtatëdhjetëvjeçar Çerçiz për atë kohë:

— Eu, si ka qenë këtu motin e parë kur kemi ardhur! Edhe kali humbiste në baltë. Nuk kishte rrugë. Shtronim





Prodhim i bollshëm qershie



kashtë në truall, sipër vinim ca dërrasa dhe flinim. Lere ç'bëhej në dimër!... Kurse tani, shiko... Jemi bërë si qytet, me hangare, me stalla, me ofiçinë, me klub, me shtëpi të bukura. Ndryshime ka bërë dhe familja ime. Njëri djalë më mbaroi universitetin dhe e kam mësues në Zvezdë, tjetri është kryeinxhinier në Pukë, vajza e vogël më lindi këtu, mbaroi shkollën e lartë në Shkodër dhe është mësuese në Sheqeras... Ja, të gjitha këto të mira na dha Partia!

Vitet nuk e kanë ligështuar xha Çerçizin. Është i gjallë dhe i shkathët, kockë e fortë. Ai e ka zemrën të gëzuar. Këtë gëzim ia kanë sjellë vitet e Partisë.

Po, këta bij të popullit, punëtorë e fshatarë, janë ata që thanë kënetën, që i bënë tokat të japin prodhime të be-gatshme, që ngritën qendrat e banimit, institucionet kul-turore, arsimore e shëndetësore të ndërmarrjes dhe që kanë sot pushtetin në dorë. Është populli zot i vendit, i jetës së tij, me në krye Partinë.

\*  
\*   \*  
\*

Pesëmijë hektarë u liruan nga ujërat e kënetës dhe u kthyen në toka buke, për panxhar sheqerin dhe pataten, në vreshta e pemëtore. Qindra e mijëra hektarë të tjerë iu shtuan nga viti në vit ndërmarrjes, e cila sot shtrihet gjer në Shtyllën e largët. Në zonën e Maliqit sot ngrihen katër sektorë kryesorë: Drithas, Sheqeras, Bregas, Vreshtas. Vetë emrat tregojnë se cilat janë profilet e tyre. Në këta sektorë banojnë 1200 familje me 6700 frymë. Ata kanë shtëpi të reja. Për fëmijët e punëtorëve janë tri shkolla 8 vjeçare dhe dy shkolla të mesme pa shkëputje nga puna me profil shëndetësore me dy mjekë dhe punonjës të tjerë të shën-detësisë. Ambulanca me pajisjet e nevojshme, që kryejnë shërbimet përkatëse, ka në pesë sektorë, ku janë ngritur edhe çerdhet dhe kopshtet e fëmijëve. Numri i arsimitarëve arrin në 64, kurse ai i punonjësve të shëndetësisë në 19. Drithasi dhe Sheqerasi kanë shtëpi kulture, salla filmi dhe shfaqjesh të tjera, shumëvendëshe, biblioteka, ndërsa në sek-torët e tjerë ka vatra kulture.

Hymë në shtëpinë e Muhametit. Edhe ky ka ardhur këtu nga malësia qysh në vitin e parë të jetës së ndërmar-rjes. Është një shtëpi e këndshme, e pajisur më së mirë me mobilje dhe orendi.

Muhameti, një burrë 50 vjeçar, na flet me emocion



duke kujtuar të kaluarën, kur ai dhe tre vëllezërit e tij endeshin andej-këtej, me çekan e mistri në dorë, për të nxjerrë kafshatën e bukës. Me emocion e gëzim Muhameti krahason të kaluarën me të sotmen e bukur dhe na tregon shtëpinë e tij të mbushur plot.

— Kemi hequr shumë para Çlirimit — tregon ai. — Kishim vetëm tre dynmë tokë. Prandaj, të katër vëllezërit, unë isha fare i vogël, vinim e punonim si muratorë në Ballsh, Vlorë, Tepelenë... Në Këlcyrë kemi punuar për shtëpitë dhe dyqanet e beut. Por ai na mbante nga paga për të cilën kishim rënë në ujdi. Nuk kishim pesë ditë që kishim zënë punë, kur na vinte letra nga shtëpia se kishin mbetur pa bukë. Dhe kur ktheheshim atje pas dhjetë muajsh, fjala e parë që na thoshnin ishte «A na sualltë bukë?» Por ne ç'u shpinim? Me ato pak para që na kishin mbetur, e blinim shtrenjt ca misër në pazarin e Korçës... Megjithatë, shpresonim se do të vinin ditë më të mira. Bëheshin greva, demonstrata, njerëzit luftonin për të drejtat e tyre. Lufta e madhe me në krye Partinë na shpëtoi. Sot shtëpinë e kam plot: me mobilje, me radio, televizor, me makinë për të larë rrobat...

E shoqja e Muhametit, ndërhy:n:

— Pse nuk i thua shokut se kur erdhëm këtu, në fermë, kishim vetëm një gomar «të ngordhur», dy jorganë të grisur dhe dy sahanë për të ngrënë. Kurse tani! Thuaji dhe për makinën qepse që kemi!

Po, ka të drejtë Kadrija. Ajo kërkon t'i numërojë të gjitha ato që ka sot. Është krenarë dhe e gëzuar, kur i del në sy jeta aq e mjerë që ka bërë ajo dikur në Gjergjevicë. Ajo lindi dhe u rrit midis skamjes dhe paditurisë, kurse sot është grua e lirë, punon dhe jeton e lumtur.

### Ushton kënga e njerëzve të rinj

Në fushat e Maliqit nuk ndihet sot kënga e zgjatur e lundërtarit të këputur. Nuk këndon më «bualli i kënetës». Sot buçet kënga e punës, e fitoreve, e njerëzve të rinj.

Me mësimet e Partisë njerëzit i lulëzuan fushat dhe kodrat. Ndërmarrja bujqësore është një ekonomi shembullore për prodhimet e saj bujqësore e blegtorale, për rendimentet e larta, për mekanikën e saj të pasur, për fermat e lopëve, të dhënve, derrave e shpendëve, për vreshtat dhe pemëtoret e saj. Njerëzit kanë përvetësuar dhe po zbatojnë gjithnjë e më shumë shkencën. Njerëz të rinj, bij të punë-



torëve e fshatarëve, kanë lindur e janë rritur këtu gjatë 25 vjetëve. Ata kanë ndjekur dhe kanë mbaruar shkollat. Ndërmarrja ka 180 kuadro të mesme e të larta në sektorët e ndryshëm.

Objektivat e punëtorëve të fushave, të pemptarisë e vreshtarisë, të blegtorisë janë përherë e më të larta. Në krahasim me vitet e para rendimentet janë më se pesëfishuar.

Mund të marrim si shembull shumë brigada fushore e të blegtorisë. Të gjitha kanë arritjet e tyre dhe veçanërisht kanë plane e zotime më të larta për pesëvjeçarin e gjashtë. Njëra nga këto është brigada e fushës, në sektorin Drithas. Brigadierja e shkathët, së cilës iu desh të luftonte çdo lëkundje dhe mosbesim fillestar në veten e saj për detyrën që i ngarkuan këtu e dy vjet më parë, tani dallohet për organizimin e mirë të punës dhe për besimin që gëzon në të gjithë anëtarët e brigadës.

Flutra është një nga punëtorët dhe brigadierët më të mirë të ndërmarrjes, e brumosur me mësimet e Partisë dhe të shokut Enver, e etur për të renë dhe për shkencën, e palodhur. Ajo mbaroi edhe shkollën e mesme bujqësore pa shkëputje nga puna. Flutra vështron gjithmonë tutje, ka ëndrra të mëdha që do të kthehen në vepra gjatë viteve të ardhshme. Kështu mendojnë, kështu ëndërrojnë njerëzit e rinj të ndërmarrjes, të cilët kanë marrë përsipër të ardhmen më të ndritur të saj.

Kjo e ardhme, në epokën e madhe të Partisë, është një e vërtetë e fuqishme që rritet e rritet përherë e më shumë.



PARTIA

Kur fëmijë nëpër rrugë cicërijnë,  
zënë dorë për dorë duke kënduar;  
në syçkat e tyre shikoj Partinë,  
në syçkat e tyre ajo ka qëndruar.

Kur dëgjoj: «U hodh mespërmes stuhisë,  
heroizëm si ky nuk është parë!»  
Aty shikoj madhështinë e Partisë,  
si bir i saj do të mbetet i gjallë.

Kur hambarët i mbushim plot me grurë,  
kur në qitje qëllojmë në shenjë,  
kur shkruajmë një vjershë të bukur shumë,  
kudo në çdo gjë shikoj Partinë nënë.

Kur shikoj oxhakët me kryet në qiell,  
pallate e shkallë pa fund e paanë  
shikoj Partinë që ndrit si diell,  
të gjitha vulën e Partisë kanë.



KËNGA MË E BUKUR PËR TY METALURGJI

Çohesh lart deri në qiell si monument madhështor  
Kudo punëtorë, vinça, ura, trase  
kish ëndëruar përherë ky vend arbëror,  
i mbushur në shekuj me kumbanare, minare.

Armiqtë s'na u ndanë nga lufta në luftë,  
rënkonte anembanë toka jonë mëmë.  
Mbetëm në shekuj gjithnjë pozicioneve  
si dritën e syve e kemi ruajtur këtë tokë,  
çdo pëllëmbë e kemi larë me gjakun e heronjve.

Gjithnjë kishin ëndërruar të parët tanë  
shpatat dhe pushkët t'i derdhnin vetë.  
Shtrihesh metalurgji pa fund, pa anë,  
derdhet djersa lumë dhe kënga buçet!

Ne do të derdhim vetë traktorë, tanke, avjonë,  
zëri i fuqishëm i atdheut më fort do të shpërthejë!  
Më ngjan kjo betejë si betejat partizane  
Më ngjan kjo betejë si më e bukura poezi.

E kush nuk ka ardhur aty në Bratashesh?  
Buçasin këngë dhe çdo gjë buzëqesh.





Metalurgu (P. Dollaku)



GJYSHJA DADE

Gjyshja ime Dade,  
vinte në mal, në arë  
kurrizin kishte plagë,  
ngarkonte dru një barrë.

Këndonte duke zbritur  
(gjyshja që nga mali):  
«Gjithë jetën duke pritur»,  
thosh një këngë malli...

I mbetën sytë në rrugë,  
mendja aty i mbeti,  
kushedi mos kthehej  
gjyshi nga kurbeti...

Jetën si në burg  
kalonte gjyshja ime  
tirrte lesh në furkë.  
tirrte plot mendime.

Tek sofati rri,  
mëngjes, drekë, darkë  
mos kthehet, kushedi,  
gjyshi që nga larg.

Të kapërcente detin,  
t'i vinte me të shpejtë  
«Kush e shpiku kurbetin,  
dheu mos e trestë!»

Mbeti te sofati,  
mbeti nëpër male,  
duke pritur gjyshin,  
ajo hallemadhe...



KËNGË PËR KUSHTETUTËN

E studiova dhe një herë  
Kushtetutën ton' të re,  
jeta jonë si pranverë,  
lartësohet gjer në re.

Flitet qartë në çdo nen  
për Atdheun tim kështjellë,  
për Partinë, që në popull,  
i ka futur rrënjët thellë.

Ne me planet pesëvjeçare,  
hej, sa lart kemi arritur,  
shtigje t'reja na thërresin  
drejt së ardhmes më të ndritur.

Me Partinë sokoleshë,  
që na prin kudo në ballë,  
me marksizëm-leninizmin,  
me thesarin më të rrallë.

Shqipërinë më të bukur  
do ta bëjmë me Enverin,  
shpëtimtarin, gojëmjaltin,  
në furtunë timonierin.

Në Atdheun ton' të lirë  
ushtar është çdo njeri,  
fort shtrëngojmë kazm' e pushkë,  
mërsho para, Shqipëri!



Ç'RA PËRRETH KY NUR I RALLË

*(Kushtuar vizitës së shokut Enver  
në Kooperativën e tipit të lartë Pojan)*

Ç'ra përreth ky nur i rallë?  
Ç'morën këngët sot kaq zjarr?  
Vjen Enveri zemra jonë  
ndër marksistët dora e par!

Grushtin lart kur çon në ajër  
dhe kur qesh sot midis nesh,  
mal e fushë bëhen këngë,  
oqean ngjan optimizmi.

Pastaj kapur dor' për dorë  
hyn në valle me valltarët  
sot kjo valle bujqësore  
ngjan si hark me ar i larë.

Nëpër lulet që ne i falëm  
(lulet ishin ngjyrë alle)  
vumë këngët, dashuritë,  
vumë zemrat si petale.

Në mendje kemi porositë,  
Që për ne janë flamur.  
Dielli ditëve të mëdha  
mbush hambarët plot me grurë.





Aromë buke — Devoll (S. Sholla)



KUR KTHEHET KOOPERATIVISTJA NGA PUNA

Tek sheh grurin kokërtë,  
lidhur bukur në stërnishte  
faqesh bie nur i rrallë  
sytë ngjajnë det me dritë.

N'ato flokë dredha-dredha  
ka diçka nga dielli i verës,  
ajo ngjyrë ç'më pëlqeka  
porsi pjalmi i luleshqerës!

Buk' e fushës nëpër kallza  
«Natën e mirë» e përshëndet  
shkollë nate vajza paska  
ndaj nxiton të mbrijë shpejt.



MOSHATARES DËSHMORE

Sot më 5 Maj  
jargavanët shpërthyen më tepër.  
Që herët në mëngjes  
buqeta të freskëta lulësh mblidhnin nënat, të gjithë.  
Të rënë mes gjelbërimit prehen  
aty në kodër mbi qytet.

Shoqe,  
hapi yt përzier me hapin tonë!  
Shoqe,  
dëgjo emrin tënd në apelin tonë,  
shiko vështrimin tënd në sytë tanë,  
në buzët tona buzëqeshjen tuaj!  
Shoqe,  
dëgjo zërin tënd në këngën tonë,  
prek ëndrrat e tua në veprën tonë!



O NËNË E DASHUR

Takova një nënë dhe sytë i lotuan:  
Tim biri sa shumë i ngjet, sa shumë i ngjet!  
Ke po ata sy, po ato duar  
dhe zërin e tij kur flet.

Dhe unë nga kjo nuk u trondita,  
tjetër gjë ma ndezi fantazinë.  
Më tha: një natë në mal atë e nisa  
dhe im bir u kthye me lirinë.

E shoh tek digjet mes shkëmbinjve,  
si lule çel  
se lule ishte,  
ndaj shpesh më flet me gjuhën e një krisme,  
ndaj shpesh në shpirt m'i ndez agimet.

Dhe unë i thashë: O nënë e dashur,  
ju lindët djem që s'vdesin kurrë,  
ata në zemrat tona do të mbesin,  
për ne gjithmonë do të jenë flamurë.



**DHE TOKA MORI FRYMË**

Dhe toka mori frymë e misri ngjizi fletë,  
në fushë përkundrejt grurit kalliblertë.

Harlisi ëmbël bari mbi lëndina,  
gërshetin bjond e shpleksi trëndelina.

Dhe bletët diku lart po heqin valle,  
mbi lulet ngjyrë roze e portokalle.

Qingjat blegërimën s'e ndërprisnin,  
tarracat një nga një në fushë zbrisnin.



## PRANVERË NË BRIGJET E FORTESËS

Stërkalat shkëlqejnë nëpër valë,  
gjethet fëshfërijnë nëpër degë,  
dielli i merr rrezet me vete,  
sytë, buzët tona janë hapur si shegë.

Ne që të dy jemi ushtarë.  
ushtarë të rinj në brigjet e fortesës,  
mbi transhen' tonë si mbi një kitarë  
hedhim notat e këngës me pikën e djersës.

Dhe kënga jonë dëgjohet kudo:  
nëpër stërkala, fëshfërima e rreze.  
Atdheun me shpirt vërtet e do,  
kur ia ruan si dritën e syrit mëngjeset.

Pranverë, pranverë, pranverë në brigje  
që kurrë s'durojnë këmbën e huaj,  
për këtë pranverë zemra më digjet  
ndaj e ruaj në shpirt dhe në transhe, e ruaj.


## LIRIKË

Fëshfërin gruri i floringjtë,  
 zverdh si mjaltë i tërë,  
 korr kombajna, korr kallingjtë,  
 pret hambari i gjërë.  
 Ti më je kooperativë  
 plot me ara, vreshta,  
 ti më je kooperativë  
 korriku dhe vjeshta.  
 Po këndon, o fshatarë,  
 po këndon këngën,  
 gruri, misri, rrush i mbarë  
 seç u ngrohka zemrën.  
 Zemrën, zemrën dritë mbushur  
 në shtëpi plot dritë,  
 lulet si livadh i gjelbër,  
 çelur mbi avllitë.  
 U këndon në zemër kënga,  
 zjarri i trimërisë,  
 këndon çiltër zëri juaj  
 për vitet e Partisë.

## II

Jam me ju shokë fshatarë,  
 jam në Myzeqe,  
 gjelbërim i fushës mbarë  
 shpirtin seç ma deh.  
 Jam mes jush shokë fshatarë,  
 jam dhe unë fshatar,  
 jam gazmor nga bimët thith,  
 erën plot nektar





Vjella e rrushit (R. Karanxha)



Jam gazmor dhe ia marr këngës  
vënçe popullore,  
marr nga ju, nga shpirti juaj,  
forcën burrërore.  
Jam tek Ti, o moj Kolonjë  
dhe këndoj gazmor  
shoh në ballin tënd të blertë  
shtatin stërgjyshor.  
Shoh ballin tënd shndrritur,  
ndezur si rubin,  
flladi i jetës socialiste  
ëmbël fërfërin.  
Ndaj më dehin pemët, lulet,  
ledhet mbushur bar  
nëpër bimët shkëlqen vesa  
shkruar si me ar.  
Më deh bari i Gramozit  
pllajat plot tërfil  
ma mbush shpirtin trëndelina  
ngjyrë trëndafil.

### III

Ngisni arave, fshatarë  
traktorin dhe qetë.  
puthni grurin në kërcellet!  
Mbushur duart u blerojnë  
misër edhe grurë  
Alo Qoses i ndrit balli  
mbi frutikulturë.  
Mbani pushkën, mbani kazmën  
mbi supë, në duar  
që të mbani në çdo brazdë  
tokën të bleruar.

### IV

Jam me ju shokë fshatarë,  
jam dhe unë fshatar,  
jam gazmor nga bimët thith  
erën plot nektar.



## ELEGJI PËR MEHMET PEPIN

Këndojnë vajzat e bukura  
 për të bukurit syt' e tu  
 këndojnë mbrëmjeve të ndritura,  
 mes vezullimesh blu:  
 «Në këngët tona,  
 kënga jote mbeti,  
 o Mehmet Pepi».  
 Këndojmë këngët e luftës,  
 këndojmë ne me zë të plotë:  
 «I bukur ishe ti,  
 o Mehmet Pepi, me sy të zi».  
 Këndojnë zogjtë përmbi shelgje,  
 mbi kumbulla ia thonë:  
 «U vra Mehmeti syshqiponjë  
 e bukura Kolonjë».  
 Kur lufta digjte dhe beharin,  
 kur mbi Gramoz zhuritej bari,  
 me krisma pushke seç ia thanë  
 një kënge shokët partizanë:  
 «O Mehmet Pepi bir stralli,  
 nga gjaku yt u skuq dhe zalli».  
 Kur dimri vjen ty të kujtojmë,  
 kur piqet gruri në korrik,  
 buzëqeshjes tënde i këndojmë.  
 Në këngët tona ajo mbiu,  
 o Mehmet Pepi flokëziu.  
 Vitet e luftës larg mbetën,  
 në gjurma lufte po fle ti,  
 këndojnë vajzat përsëri:  
 «Na mbete larg në duman,  
 o Mehmet Pepi partizan;  
 na erdhe afër midis nesh,  
 ti prapë me diellin buzëqesh»!

## SA HERË PUSHKËN E KAM PREKUR

*(Kushtuar dëshmorit Ramiz Trimi)*

Sa herë pushkën e kam prekur  
mbi shpate malesh, diku në llogore,  
më je shfaqur trim e i paepur,  
partizan i kuq i tokës stërgjyshore.

Më je shfaqur tutje në luftime  
netëve me yje e me hënë,  
zëri yt më vinte mes gjëmimeve,  
si ortek që zbret malit me gjëmë.

Më je shfaqur me vështrim të ndritur, krenar,  
pranë xhelatësh rreth me bajoneta,  
thika m'u në gjoks të ka goditur  
ti qëndron, qëndron si mal me shkrepë.

Sa herë unë pushkën e kam prekur,  
mbi shpate malesh diku në llogore,  
gjaku yt në deje më është derdhur  
ditëve me diell, netëve hënore.



## REND TRANSHEVE TË KUQE

Rend maleve në shpate e lugje,  
rend fushave me grurë rënduar,  
rend transheve të kuqe,  
me pushkën në duar,  
me syrin në shënjestër.  
me dashuritë e jetës në zemër

Në zemër mbaj të gjitha dashuritë  
në shënjestër kam futur armiqtë.

**TRIM O PËR LIRI**

*(Kushtuar Xhelal Shtepanit)*

Gjoksin ti e hape  
gjoksit mbinë plagë,  
zemra jote trime  
diell e det me dallgë.

Gjaku yt pikoi  
në gurt' e vatanit,  
i patundur prapë  
si rrënja e malit.

Dheu është i kuq  
atje ku re ti,  
atje ku dhe jetën,  
trim, o për liri!



**VOGËLUSHI PARTIZAN**

*(Heroit të popullit Çelo Sinani)*

Vogëlush, Çelo si era,  
rend e rend, kërkon liri  
nëpër plumba, nëpër predha  
nëpër malë me stuhi,  
populli këndon për ty  
«Lule Çelo Sinani».

Po kjo era e barutit  
të burrëroi: të dha zemër,  
të çaje shtrëngata moti,  
në atdhe të mbinin këngët  
të këndon agimi ri  
«Lule Çelo Sinani».

Ecën me shokët rreshtuar  
rrugët mbushur me dëborë  
këngë e dashur e brigadës  
seç të mbeti nëpër gojë  
siç na mbeti ne për ty  
«Lule Çelo Sinani».

## BALLADË PËR ÇOBANIN

Heshtën pyjet, heshtin malet  
dhe këmborët në luadhe.  
Dhent' s'kullosin, blegërijnë,  
varën kokën për barinë.  
Ai shtrirë nën gështenjë  
me tre thika i kanë rënë.

Ata ikin... u nxin nata,  
i tremb hapi nëpër shkarpa,  
i tremb kaçubi, murrizi  
dhe një zë mbrapa kurrizi  
— Ndal! — u duket se ushton  
hapi, hapin e ngatërron.

— Ndal! — ushton i gjithë pylli  
toka tërë shtigjet mbylli  
dhe agimi mbrapa mali  
si ëndër e çobanit zbardhi  
Përreth panë dhjetra gryka,  
dhjetra çobenj në boriga.

Dhe fyelli këngës ia tha:  
— Fli çoban, more vëlla!  
Sa pyje, male të ketë  
hymni tënd me to do jetë  
Se për to armiqt të ranë  
Deshën rrugën për matanë.

— Fli — i thonë këmborë e dhënë  
se dhe ne këngën tënde  
do ta çojmë në Veri,  
mal më mal dhe përsëri  
do të vemë ku dergjesh ti,  
kur të bëhet bar' i ri.



— Fli, — i thotë kope e malit,  
— dyshek ke lulen e barit  
tokën tonë shtrat të fortë,  
natën yjet përmbi kokë.  
Dashuri e tokës son'  
si jorgan, trim, të mbulon.

Mbi kokë të çobanit mbinë  
Lulekuqe, trëndelinë.  
Syri agimit kur del,  
Gonxhet e reja i çel  
Dhe çdo vit kopeja e malit  
Lëndon zemrën e çobanit.

**KËNGA JUAJ, ZJARR E FLAKË**

*(Kushtuar korit karakteristik të Korçës)*

Me gaz pritët çdo pranverë,  
buzëgaz këngës ia kini marrë,  
tek ju s'gjen vend pleqëria  
gjak i ri vlon nëpër damarë.

Me Enverin në mes tuaj,  
ju u rritët n'ato vite  
nëpër sheshe demonstrata,  
ngritët hymne mbas çdo prite.

Me këngë ju ngritët trimat  
dhe qëlluat çdo të huaj  
heroizmin mori vargu,  
ia ngjiti buzës suaj.

Ju e ngjallet Skënderbenë,  
dhe Gramenon, kapedan,  
Themistoklin' e Korçës plakë,  
pritët trimat partizan.

Kënga juaj mos pushoftë  
nëpër nipa e stërnipa,  
Kënga juaj zjarr e flakë  
Ndrriçon yllin me pes' cepa.





Kori i këngëve karakteristike të Korçës

KËNGË THURR KAVALLI

*(Heroit të Punës Socialiste Hysen Seriti)*

Sulet dallg' e ujit  
përmbi gjoksin tënd,  
ti shkon ballë saj  
skalitur në shkëmb.

Në shtegun ku shkon  
këngë thurr kavalli,  
shokt' e tu barinj  
thon' një këngë malli.

Ç'të mbetën dhe shumë  
për matanë bregut  
shiu bëhet lumë  
dhe ia hipën shtegut.

Era e marrosur  
fletë drurësh grin,  
në këmbor' të dhenve  
frika tringëllin.

Blegërin një dele  
ti e njeh me emër  
tufa kolektive  
t'u rrit mu në zemër.

Hidhesh për matanë  
bejkën merr në gji,  
porsi shkumb' e bardhë  
nëpër ujë të zi.

Dallgët seç të marrin,  
edhe të mbulojnë...  
po ti ngrihesh prapë,  
delet të kërkojnë.



K T H E H E M

Ja ku po kthehem prapë  
unë bujku i shkolluar  
kërcet kalliri nëpër vapë  
m'uron me kokën e rënduar.

Në fushë sot sikur më flet  
çdo flutur dhe çdo lule.  
Të duan udhët me tërfil  
ku fëmijërinë ngule.

Si mbi qilima ç'po më shkel,  
thëllëza ime e drojtur,  
mes luleshqerash hyn e del  
gjoja, s'më ke njohur.

Të vura re që prej së largu,  
shaminë era se ç'ta dredh  
në zemër se ç'më mbiu vargu  
si bim' e gjelbër këtu rreth.

Si ndiqnim shqerkat në korie...  
(kujtimet celin një nga një)  
më thoshe ti me zë fëmije:  
«Do mbjellim grurë përgjithnjë»!

Po eja mikja ime, eja,  
të ndiesh, ç'kam në zemër,  
çdo vis të fushës kam në gjak,  
çdo lule njoh me emër.



Aksionistja (I. Shaholli)



**XHAXHA NEXHIPI**

Hapen shtigjet mal më mal  
këmb' e mushkës gur më gur;  
lodhja këngën ka ilaç  
dhe burimin në pagur.

Hejbet tunden mbi samar,  
mbi fishekët dy tri bukë...  
— Mbahu sive, mbahu ca,  
se s'na mbeti shumë rrugë.

Shket' potkoji mbi gëzhoja  
dhe opingat guri grin...  
Xha Nexhipi ngjitet lart,  
për atje ku ylli ndrin.

Hejbet tunden mbi samar  
dhe mendimet rrotull vijnë:  
— Nemçe, ujk, t'i thyem dhëmbët...  
s'kishe njohur devollinë...

TEK TË RËNËT

Ne mbushim duart me buqeta  
nisemi tek të rënë,  
ulemi pranë tyre  
e zjarrtë nis biseda.

Natën  
ecën nëpër rrugica,  
si pishtarë të zjarrtë  
u kalitën në male,  
u rritën nëpër prita.

Ne flasim  
për fitoret e reja,  
si mposhtëm vështirësitë  
si rritemi në beteja.

Ecim  
mes rrugës plot dritë  
në mendje dhe në zemër  
biseda për trimëritë.



HEROIT

*(Kushtuar Llazi Pulluqit)*

Nuk doje ferra në tokë,  
vendin s'e shihje dot nën re.  
Të dy duart për një kokë,  
ndërsa koka për Atdhe.

Me urrejtje, besim u ngjite,  
me gjak plumbat armiq prite.  
Nga malet dëgjohej jehona  
në pushkë mbaje ditët tona.

Gjaku yt kristal i pastër  
i lirisë një burim.  
Zemra jote e madhe, e zjarrtë  
rreh në gjoksin tim.

XHA HALIMI DHE UNË

Herët kur dielli syrin nxori,  
lart mbi sup të malit në shkrep,  
kur bilbili këngës ia mori,  
u nise ti me çibuk në xhep.

U nise ti se të mori malli,  
për qentë, bagëtinë në vathë  
kur mbrite, xha Halim çobani,  
me vrap t'u hodh Muroja në qafë.

Cjapi Bardho duart të lëpinte,  
ndërsa manari të ndiqte pas  
e mushka kërre hingëllinte,  
Ti përkëdhelje me buzë në gas.

'Seç të mori malli për burimet,  
për zoqtë këngëtarë të lajthisë,  
për lulet edhe gjelbërimet,  
për ketrin, që hidhet lis më lis.

Erdhe në stan pranë shtratit  
dhe gjete një bari më shumë;  
gëzimi t'u derdh si lumë shtatit,  
blektori i ri isha unë.

Çibukun mbush me duhan të grirë,  
më tregon si rritet bagëtia,  
eshka jote shpërndan erën e mirë,  
vesa largohet që nga lajthia.

Mësova nga ju jetën e madhe,  
do bëhem dhe unë blektor shpuzë,  
do rrit dhentë sa një sarkadhe,  
vedrën me qumësht buzë më buzë.



**BARIU I VOGËL**

Dielli pa rënë  
maleve kurorë,  
Genci ngjitet lart  
me krabën në dorë

I pëlqen atij  
maleve në verë  
pas babit bari  
të rrijë ngaherë.

Tani është nxënës,  
kur të rritet — thotë  
bari i dalluar  
maleve do ngjitet

— Porsi ata  
do bëhem patjetër,  
qumësht i bardhë të rrjedhë  
më shumë në vedër.

POEZIA

Kaq thellë s'kisha hyrë në tokë,  
larg kisha shkuar, po thellë jo.  
Atdheu me qiellin është mbi kokë,  
lumturia nga këto thellësi i buron.

Burojnë ujërat, burojnë energjitë,  
burojnë dritat, ngjyrat, buzëqeshjet.  
Unë shetit i heshtur galeritë  
me oshëtimën e minave në veshë.

Të dirsur, të qeshur, sytë yje,  
shëtis e ndesh me poezinë  
rrënjët e saj në thellësi i mbijnë,  
në zemrat e njerëzve lart ka lulet.



## SI LUAN TË RRTI

Me shaminë e kuqe  
me yllin në ballë  
pushkën përmbi supe  
ti shkove në male.

Unë të përcolla  
tjetër nën' të priti,  
ajo nënë e madhe,  
si luan të rriti.

Pushka t'u bë nënë,  
dyshek kjo tokë,  
partizanët, prindër  
dhe fishekët, shokë.

Këngë e lirisë  
afër po dëgjohet,  
po vijnë partizanët  
populli gëzohet.

Me shaminë e dorës  
si erë vrapova,  
me mallin e nënës  
ty, të përqafova.

Ç'të ndriçon ky ylli  
dritë për lirinë  
rreze, rreze yjesh,  
sot mbi Shqipërinë.



Dëshmori Raqi Themeli (A. Themeli)



EPILOGU I NJË POEME PËR  
RIZA CËROVËN

O Riza Cërova,  
trimi skraparlli,  
eshtrat thellë në tokë  
zemra në liri.

Jeta jote — luftë,  
zemra jote — shpatë  
trim i paepur  
rritur në shtrëngatë.

O Riza Cërova,  
trimi skraparlli,  
fjala jote plumb,  
syri yt shkëndi.

Atdhetar i flaktë,  
revolucionar,  
komunist për jet'  
mbete si pishtar.

O Riza Cërova,  
trimi skraparlli,  
eshtrat thellë në tokë  
zemra në liri.

STUDENTJA USHTARE

E kini parë vajzën me kaçurrela  
Me trup të lartë, me pushkë në krah?  
Ajo është më e bukura studente,  
«armikut» plumbat në zemër i dha.

E kini parë si vrapon transheve  
me vërtik si lumenjtë malorë?  
Ajo është rebeshi i rebesheve  
me vezme në brez e pushkë në dorë.

E kini parë? Duhet ta njihni  
studenten ushtare me flokë kaçurrela,  
që zjarr derdh mbi «armikun»,  
stërvitet e djersin transheve.







## POPULLSIA E RRETHIT TË KORÇËS DHE DINAMIKA E SAJ

Gjurmët e banimit në territorin e Korçës futen në thellësinë e kohërave më të lashta parahistorike, këtu e dhjetëderi dymbëdhjetë mijë vjet më parë. Këtë e dëshmojnë vendbanimet, gjurmët e të cilave janë gjetur gjatë gërmimeve arkeologjike sidomos në Tren, buzë Prespës së Vogël, në Maliq etj. Gjurmët e vendbanimit parahistorik të Maliqit u zbuluan më 1948 nga punëtorët, gjatë tharjes së kënetës dhe kanë rëndësi jo vetëm për historinë e Shqipërisë, por edhe për atë të Ballkanit, mbasi në to është zbuluar një pasuri e madhe arkeologjike.

Banorët e rrethit të Korçës, ashtu si gjithë popullin tonë, i ka karakterizuar gjatë gjithë historisë heroizmi popullor, patriotizmi, dashuria për punën, trimëria, besnikëria e guximi. Këto cilësi të mrekullueshme janë zhvilluar e kultivuar edhe më shumë sot në kushtet e transformimeve të thella ekonomiko-shoqërore që janë bërë e bëhen në vendin tonë nën udhëheqjen e Partisë për ndërtimin e socializmit.

Siç dihet për të studjuar popullsinë e një vendi është e domosdoshme të bëhen regjistrime të rregullta të saj. Para Çlirimit janë bërë dy regjistrime: më 1923 dhe më 1930. Shifra më të sakta për numrin e popullsisë së rrethit të Korçës gjejmë pas vitit 1923, në regjistrimin e parë të përgjithshëm të popullsisë së Shqipërisë, sipas të cilit popullsia e këtij rrethi ka qenë 67.833 banorë.

Pas Çlirimit të vendit janë bërë pesë regjistrime të përgjithshme të popullsisë, më 1945, 1950, 1955, 1960 dhe më 1 prill 1969. Këto regjistrime janë bërë jo vetëm për të njohur numrin e popullsisë të të gjithë vendit ose të çdo rrethi, por edhe ndarjen e saj sipas profesioneve, shkallës së kulturës, përbërjes klasore etj.



Regjistrimet e viteve 1960 dhe 1969 tregojnë jo vetëm numrin e popullsisë sipas ndarjes administrative në shkallë republike, por edhe sipas mjeshtrive të banorëve, vendbanimit të tyre etj.

Rrethi i Korçës ka një popullsi prej më se 176.900 banorësh, numër ky që është mbi 2.6 herë më i madh se ai i vitit 1923 dhe mbi 1.5 herë më i madh se i vitit 1938.

Viti	Numri i popullsisë	Rritja në përqindje
1923	67.833	
1945	103.531	100.0
1960	139.271	152.5
1972	172.800	205.3
1973	175.400	254.7
1974	176.900	258.5
1975	179.900	260.8
		264.8


Të dhënat e sipërme tregojnë se numri i popullsisë së rrethit të Korçës është rritur vazhdimisht, por rritja më e madhe vihet re sidomos pas vitit 1950. Në këtë rreth, si kudo në Shqipëri, është ngritur mirëqënia e përgjithshme e popullsisë, janë ngritur një rrjet i gjerë institucionesh shëndetësore e sociale, spitale, maternitete, kopshte, çerdhe dhe janë krijuar kushte të tjera të favorshme që kanë bërë të shtohen lindjet dhe të pakësohen vdekjet.

Ja ç'tregojnë shifrat gjatë periudhës 1950-1972, të llogaritura për 1000 banorë për rrethin e Korçës.

Viti	Lindjet	Vdekjet	Shtesa natyrore
1950	35.4	12.5	
1955	36.5	13.6	22.9
1960	40.3	11.1	22.9
1965	32.0	8.4	29.2
1969	29.0	7.4	23.6
1970	25.6	8.4	21.6
1971	25.8	6.9	17.4
1972	23.5	7.0	18.9
1975	23.9	6.6	16.5
			17.3

Këto të dhëna tregojnë se në periudhën 1950-1972 në rrethin e Korçës shtimi mesatar i lindjeve ka qënë 32 për mijë, i afërt me atë të Shqipërisë (33 për mijë). Shtimi natyror i





Pamje e qytetit të Korçës



popullsisë gjithashtu ka ecur përkrah pakësimit të vazhdueshëm të numrit të vdekjeve. Koeficienti i vdekjeve (periudha 1950-1971) është 10 për mijë, pak më i lartë se ai i tërë Shqipërisë (8 për mijë). Përsa u përket vdekjeve gjatë viteve 1950-1975, numri i tyre është lëkundur nga 13.6 për mijë në 6.6 për mijë. Në vitet 1965-1970 numri mesatar i vdekjeve ka qenë edhe më i vogël, afërsisht sa ai i tërë Shqipërisë, rreth 8.2 për mijë, ndërsa në vitin 1975 ai zbriti në 6.6 për mijë. Prandaj rritja e popullsisë së rrethit të Korçës, ashtu si e gjithë Shqipërisë, është kryesisht rezultat në radhë të parë i uljes së theksuar të koeficientit të vdekjeve, por dhe i numrit të lartë të lindjeve.

Shtesa natyrore për periudhën 22-vjeçare 1950-1971 është lëkundur nga 17.4 deri në 29.2 për mijë, ndërsa ajo mesatare është 23.2 për mijë ose 232 frymë për çdo mijë banorë.

Rritja natyrore e popullsisë gjithashtu duket qartë edhe në ritmin mesatar vjetor të shtimit të popullsisë, i cili është lëkundur nga 1.5 - 2.5% (periudha 1950-1971). Prandaj rritja me ritme të shpejta e popullsisë të rrethit të Korçës, siç ndodh edhe në rrethet e tjera të Shqipërisë, është një nga treguesit e ngritjes së përgjithshme të nivelit materialo-kulturor të masave të gjera popullore gjatë pushtetit popullor nën udhëheqjen e Partisë e të shokut Enver. Moshë mesatare e njeriut është rritur deri në 68-69 vjeç, aq sa është rritur moshë mesatare në shkallë republike.

Shtimi i numrit të popullsisë solli dhe rritjen e dendësisë mesatare nga 53,8 për km<sup>2</sup>, që ishte më 1938, në 81 banorë për km<sup>2</sup> më 1974, aq sa është dendësia mesatare e Shqipërisë (80 banorë për km<sup>2</sup>).

Shpërndarja e popullsisë në rrethin e Korçës nuk është e barabartë për gjithë territorin, mbasi dhe dendësia ndryshon nga zona fushore tek ajo malore. Por zhvillimi i ekonomisë dhe i kulturës gjatë pesëvjeçarëve ka sjellë gjithnjë rritjen e dendësisë së popullsisë si dhe shpërndarjen më të drejtë të saj.

### **Përbërja e popullsisë sipas moshave**

Po ta shohim përbërjen e popullsisë së ndarjes sipas moshës, do të vërejmë si të dhënat e sotme tregojnë që në rrethin e Korçës dominon moshë e re. Kështu popullsia në moshën e punës zë rreth 49.5% të numrit të përgjithshëm të popullsisë, përqindje kjo që i afrohet asaj të Republikës



(50%), popullsia nën moshën e punës ze mbi 34.5%; shifër mjaft më e ulët nga ajo e gjithë vendit (42%) dhe popullsia mbi moshën e punës zë 16%. Zhvillimi i vullshëm i forcave prodhuese i shoqëruar me krijimin e degëve të reja të ekonomisë, hapi fronte të reja pune, gjë që solli rritjen e theksuar të numrit të të zënëve me punë të popullsisë aktive. Mjaft e theksuar është sidomos rritja e pjesëmarrjes së gruas në prodhim. Kështu p.sh. ndërsa në vitin 1960 gratë përfaqësonin 28.3% të numrit të përgjithshëm të fuqisë punëtore, më 1970-1971 kjo shifër ariti përkatësisht 41.9% dhe 43.4%.

Në krahasim me vitin 1960 më 1971 pjesëmarrja e gruas në punë në qytet është rritur 290%, ndërsa në fshat pjesëmarrja e gruas nga 45 për qind që ishte në vitin 1966, në 1971 u rrit 47.6 për qind.

Në rrethin tonë gruaja përbën mbi 40 për qind të fuqisë punëtore. Ky është një tregues i qartë dhe kuptimplotë, që vërteton se Partia dhe pushteti ynë popullor i hapën horizont dhe perspektiva të mëdha gruas, i krijuan të gjitha kushtet objektive dhe subjektive për ta nxjerrë nga kuadri i punëve shtëpiake dhe për ta hedhur në punën shoqërore për ndërtimin e jetës së re socialiste në vendin tonë. Nuk ka vepër, nuk ka sektor në rrethin e Korçës ku të mos jetë derdhur edhe djersa e gruas. Ka ndërmarrje këtu si p.sh. kombinati i trikotazhit ku 90 për qind e punonjësve janë gra e vajza.

### Popullsia qytetare dhe ajo fshatare

Në rrethin e Korçës pesha specifike e popullsisë qytetare në vitin 1938 ishte 20.2% kundrejt asaj fshatare, e cila ka qenë 79.8%. Shifrat e vitit 1938 tregojnë se përqindja e popullsisë qytetare për këtë rreth në krahasim me atë të Shqipërisë ka qenë pak më e lartë (4.8%).

Në vitet e pushtetit popullor, popullsia qytetare është rritur si pasojë e zhvillimit të industrisë etj. dhe nga rritja e numrit të qyteteve. Kështu në prill të vitit 1969 përqindja e popullsisë qytetare e këtij rrethi ka qenë 33.3 për qind dhe ajo fshatare 66.7 për qind, më 1974 33.4%, 66.6%, ndërsa më 1975 ishte 33.7% dhe 66.3 për qind. Këto përqindje janë të afërta me ato në shkallë republike.

Pas vitit 1945, në rrethin e Korçës vihet re një rritje e dukshme e popullsisë qytetare, e cila ka ardhur jo vetëm nëpërmjet shtesës natyrore të saj, por edhe si rezultat i



shtesës mekanike të qyteteve, si dhe i lindjes së qyteteve të reja, siç është ai i Maliqit.

Kongresi i 6-të i PPSH orientoi që të mos lejohet lëvizja spontane e popullsisë nga fshati në qytet, gjë e cila shpie në shpopullimin e fshatit, siç ndodh në vendet kapitaliste e revizioniste ku popullsia e fshatit pakësohet vazhdimisht. Në vendin tonë lëvizja e fuqisë punëtore nga fshati në qytet është bërë dhe bëhet kurdoherë në mënyrë të planifikuar dhe në përpjesëtime të drejta, në përputhje me nevojat e zhvillimit të industrisë socialiste, me intensifikimin e prodhimit bujqësor, dhe në kushtet konkrete të vendit tonë. Prandaj shtesa e popullsisë qytetare sidomos gjatë 10-15 vjetëve të fundit është bazuar kryesisht në rritjen natyrore të vetë popullsisë qytetare, e cila duhet të sigurojë fuqinë punëtore të nevojshme për industrinë në zhvillim, me qëllim që të mos shpopullohet fshati ynë, që ai t'i përgjigjet zhvillimit të harmonishëm si të industrisë ashtu dhe të bujqësisë.

### Qyteti i Korçës

Qyteti i Korçës është ndërtuar në lindje të fushës së Korçës dhe pranë kodrave «Partizan», Alfabet» dhe «Rinia» që janë para maleve të vargut të Moravës; qyteti është vendosur në lartësinë 869 metra mbi nivelin e detit dhe është më i larti në këtë drejtim po ta krahasojmë me lartësinë e qyteteve të tjera të vendit. Qyteti i Korçës ka një pamje mjaft piktoreske. Kodrat e veshura me drurë të ndryshëm, faqet e tyre të punuara, malet e Moravës, fushat e mbjella e të sistemuara rreth e rrotull e bëjnë këtë qytet edhe më të bukur e tërheqës.

Korça është një qytet relativisht i ri. Emri Korçë del për herë të parë në vitin 1505, në një dokument origjinal turk, i firmuar nga sulltan Bajaziti II. Zbulimet e fundit arkeologjike, të bëra në afërsi të kodrave «Partizan» vërtetojnë se territori i tij është banuar që në shekullin V dhe VI. Ky vendbanim njihej me emrin «Goras» apo «Goricë», nga mendohet të ketë rrjedhur edhe emri i Korçës.

Si qytet Korça del në dritë në shekullin XV e XVI dhe filloi të zhvillohet sidomos në shekullin XIX, pas shkatërrimit të Voskopojës; një pjesë e mirë e voskopojarëve erdhën dhe u vendosën këtu. Që nga ajo kohë Korça filloi të bëhet një nga qendrat më të rëndësishme tregtare, industriale dhe kulturore të vendit tonë.



Numri i popullsisë të këtij qyteti në vitin 1923 ishte 25.598 banorë. Por pas këtij viti ky numër erdhi duke u pakësuar si pasojë e shpërnguljes së një pjese të popullsisë (refugjatë), e cila ishte vendosur përkohësisht në këtë qytet gjatë Luftës I Botërore, për t'u rikthyer përsëri në fshat dhe sidomos për shkak të papunësisë së madhe dhe të emigracionit gjatë periudhës së viteve 1924 deri në 1935. Në vitin 1938 popullsia e Korçës ishte 21.221 banorë. Ndërsa nga viti 1938 e deri më 1971 është shtuar 2.2 herë. Por ritmi i shtimit saj ka qenë më i ngadalshëm se ai i qyteteve të tjera të mëdha (Tiranës, Durrësit, Vlorës). Kështu, gjatë periudhës 1945-1971, rritja mesatare vjetore e përgjithshme e popullsisë së Korçës ka qenë 3.6% më e madhe se ajo e Shkodrës, por më e vogël se ajo e Tiranës (7.3%), Durrësit (11%), Vlorës (11.7%). Në vitin 1974 qyteti i Korçës kishte 50.200 banorë, ndërsa më 1975 kishte 52.100 banorë.

Gjatë historisë së popullit tonë Korça ka dhënë një kontribut të madh në zgjimin e ndërgjegjes kombëtare. Për këtë flasin «Evetari» i Naum Veqilharxhit nga Vitkuqi, i cili u botua në vitin 1844, «Bleta Shqiptare» e Thimi Mitkos botuar më 1878, shkolla e parë shqipe, e cila u hap më 7 mars 1887 etj.

Më 10 dhjetor 1910 në mitingun e mbajtur nga patriotët korçarë në kodrën e «Shëndëllisë», e cila sot quhet kodra e «Alfabetit», hodhën poshtë alfabetin arab të përkrahur nga feudalët dhe klerikët. Popullsia korçare është shquar gjithashtu edhe në luftën patriotike për liri. Pas viteve 1905-1908 u krijuan çetat kryengritëse të Mihal Gramenos, Spiro Bellkamenit dhe të patriotëve të tjerë, të cilët luftuan kundër sundimit turk e synimeve grabitqare të shovinistëve grekë. Më 1916 patrioti korçar Themistokli Gërmenji shpalli «Republikën Autonome të Korçës».

Gjatë periudhës famëkeqe të sundimit feudalo-borgjez të Zogut, populli i rrethit të Korçës luftoi si kurdoherë kundër këtij regjimi të urryer. Kështu u forcuan edhe më tepër traditat revolucionare të rrethit. Në vitin 1931-1933 themelohet Grupi Komunist i Korçës, i cili luajti një rol të rëndësishëm për përhapjen e ideve komuniste në Shqipëri, si dhe në luftën e popullit kundër regjimit antipopullor të Zogut. Ky grup krijoi shoqërinë «Puna», atë të «Rrobaqepësve», të «Këpucarëve» etj. Në Grupin Komunist të Korçës kanë milituar shokët Enver Hoxha, Mihal Lako, Ali Kelmendi, Teni Konomi etj. Demonstratën e bukës të 11 shkurtit 1936 e udhëhoqën komunistët.



Popullsia e këtij rrethi ka luajtur një rol të rëndësishëm në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare. Korça është edhe qytëti i demonstratave. Më 8 nëntor 1941, ditën që u themelua Partia Komuniste e Shqipërisë, u bë demonstrata antifashiste ku ra heroikisht komunisti Koci Bako. Më vonë u bënë edhe të tjera demonstrata e manifestime kundër fashistëve.

Korça u çlirua më 24 tetor 1944 nga forcat partizane. Gjatë viteve të pushtetit popullor rrethi i Korçës ashtu si i gjithë vendi, nën udhëheqjen e Partisë, ka bërë përparime të mëdha.

Të gjitha këto kanë bërë që të rritet mirëqenia e popullit të këtij rrethi, të përmirësohen së tepërmi kushtet e jetesës dhe të çelënikoset dashuria dhe uniteti i popullit korçar rreth Partisë sonë të Punës me në krye shokun Enver Hoxha, që sollën këto ditë kaq të mira.

Teksti: F. Gërmenji

Muzika: J. Minga

## DITËLINDJA E MADHE

Përse qeshin sot fytyrat, shok',  
edhe gaz të madh në zemër ndjejmë ne.  
Tridhjet e pesë vjet Partia jonë mbush  
vjen ditlindj'e madhe, hej.

Nëpër sytë tan' vështrim krenar,  
për nënën tonë që gjithçka na dha,  
shprehim dashurinë që e pastër rrjedh,  
nga çdo zemër pionieri,  
Ditlindjen t'urojm, o nën'e shtrenjtë Parti!

*Refreni:*

Rrofsh Parti, udhëheqsi yn' Enver,  
Me ju jemi ne në çdo betejë.  
Emrin komunist e kemi ne për nder  
do punojmë e do mësojmë ta meritojm.  
Rrofsh Parti, udhëheqsi yn' Enver,  
me ju jemi ne në çdo betejë.  
Në marshimin tonë s'ka gjë që na ndal  
me Partinë në ball'.

## II

Në kët' fest' të madhe plot gëzim,  
sa je zbukuruar o Atdheu im!  
Shtigjeve të reja ballëlart marshojmë  
vjen ditlindj'e madhe, hej.

*Refreni:*

etj...



# DITLINDJA E MADHE

MUZ J Minga  
TEKS. F. Gërmenji

*All.<sup>o</sup> VIVACE*      Re +      Fa# -      Mi - La#

Perse geshim sot fy - ty rat shok  
edhe goz te madh ne zemer ndejme ne  
tridhjet e pes vjet far - ti - o jone mbush  
vjen ditlindje ma - dhe hej  
ne per sy te tan vesh - trim kre - nar  
per ne nen to ne qe gjith - cka - na dha  
shprehim da shu - ri - ne qe e pastër rjedh  
nga qob ze - mer pi - o - nier Dit -  
lindjen tu rajme o nenë e shtrenjt Parti

Detailed description: This is a musical score for the song 'DITLINDJA E MADHE'. It is written in G major (one sharp) and 2/4 time. The tempo is marked 'All.<sup>o</sup> VIVACE'. The score consists of ten staves of music. The lyrics are written below the notes. There are various musical notations including slurs, ties, and dynamic markings. The lyrics are in Albanian and celebrate the birth of the Party.

Ro+ Mi- La+

Profsh Par - ti udhë - heqsi yne En - ver

Re+ Mi- La+ Sol+

me ju je - mi në cdo be - tej

Fo#+ Fa#+ Si-

Emrin komu - nist e kemi ne per nder

ne marshimin tonë ska gjë që na ndal

1 Do#+ La+

do më - sojme e do punojme ta me - ri - tojmë

2 Do#+ La+ Re-

me Par - tin në ball



Teksti: P. Samsuri

Muzika: P. Sholla

### MË ZGJOI KËNG' E FSHATIT

Më zgjoi këng' e fshatit, shokë,  
seç kumbon e gjallë;  
hidhet vallja, dridhet, dridhet  
hapet valë-valë.

Sikur hap dritaren, shokë,  
të shoh lashtësinë,  
kur kënga bashkohej  
bashk' me trimërinë.

*Refreni:* O si hidhen vallet  
me hov djaloshtar,  
mbështetur e derdhur  
mbi taban shqiptar.  
Nënat tona, gjyshet, o moj,  
vallet për oborre  
gjyshrit me opinga, o moj,  
dhe shaminë në dorë.

Këng' e valle paçim, shokë,  
lart nëpër oxhaqe,  
në të gjërat fusha.  
në të shtrenjtat pragje.

"  
MË ZGJOJ \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_ KËNGA E FSHATIT

MUZ Pavlo Shoila  
TEKS Petraq Samsuri







«Nëntor 1944» (S. Sholla)



## VAJZ' E FUSHËS, DJAL' I MALIT

Seç fryn një erë,  
të tundi shaminë  
në fushën e gjerë  
kur gruri ka mbirë.

Era që fryn  
djersën ç'ta than'  
mundi punës sonë  
ky gruri i art.

*Refreni:* Eja vajzë dhe moj,  
shoqet të thanë,  
t'i këndojmë fushës  
së paanë  
buk'e saj na rrit,  
hajde dhe moj,  
Shqipërisë t'i shtojmë  
begatitë!

Seç fryn një erë  
dhe këngën ta merr  
ia çon lart në male •  
bariut që pret.

Është kënga jonë  
punë e dashuri,  
ndaj të dua fort  
sa më do dhe ti.

*Refreni:* Në mes shoqesh dua, moj,  
grurin të rrit,  
lart në stane qumështin  
si burim,  
Zërat tona, dhe moj,  
një këngë këndojnë  
Shqipërisë t'i shtojmë  
begatinë!



VAJZ' E FUSHËS,  
DJAL' I MALIT

MUZIKA. J. Minga

ORK.

Sec fryn një er: të  
 tun-di sha - mi - në. \* Ne fu - shën e gje-rë ku gru-ri ka  
 mbirë E-ra që fryn e djer-sën ç'la than O \* mun-di p'u-nes  
 so-në ky gru-ri i art E ja vajz'dhe  
 maj sha-gej te tha-ne ti ken-dojme fu shës së pa an  
 Buk'e saj na ri-ti Haj-de dhe maj Shqi-pe-ris-ti  
 shtoj-me be-ga-tin D.C.

Teksti: Maksim Treska

Muzika: Gjergj Kote

## MOTIVE FESTIVALI

U mblodhën krahinat  
si përrenj të kthjellët  
në udhën e këngës.  
me detin e zemrës.

Këngë si petale  
çelin përmbi buzë.  
Fustanella vallesh  
ngrihen dallgëshumë.

*Refreni:* Vallet, këngët, zemrat  
një zjarr të kuq mbajnë,  
në ditët e reja  
rrjedh tradit'e lashtë.

Dhe të rinjt'e fshatit  
në podjume derdhin  
jetën e begatë  
si një ditë pranvere.

## II

Këndon grup'i djemve  
këng' polifonike,  
zgjaten tingujt, zërat  
si udh' historike.

Ja dhe vajzat tona  
me zërin e ëmbël,  
ngjajnë porsinota  
mbi tastiera këngësh.

*Refreni:* Vallet, këngët, zemrat... etj.



MOTIVE FESTIVALI

MUZ Gjergji Kofe  
TEKS. Maksim Treska

*Allegretto canto*

U mblodhën kra-hi-nat si përrenj te këthje-llet, me u dhënë

këngës me detin e zemrës kënga si pe-ta-le-çe

lin për mbi buze fustanella vallesh ngrihen dallge

shu-më Va llet këngët zemrat Një zjarr i kuq mba

inë -- Në di-tet e reja rrjedh traditë lashitë

dhe të rinjt e fsha-tit në po-dju-me derdhin

jetën e be-ga-të si një dit pranvere në Fine

Për Fine

D.C. NË

Teksti: M. Gjergji

Muzika: S. Vangjeli

## FESTA E MADHE

U shkri bora majave Moravës,  
gëzimi përhidhej sy më sy:  
Udhëheqsi tek ti paska ardhur  
është shtruar këmbëkryq me ty.

*Refreni:*

Hej, moj Korçë, do të rrjedhin ngjarjet  
si rrëketë shpatit mbi Devoll,  
Po kjo ditë, e kjo dit' e madhe  
zën'e tij gjithnjë do të t'kujtoj.  
Flet Enveri: zemrat hapin dyert,  
njerëzit kok' më kokë mbajnë vesh  
se po flet' o bir i madh i tyre,  
dielli që ndrit në çdo rrebesh.

## II

Derdhet optimizmi nëpër zemra,  
merr gërneta një motiv të ri  
dhe s'andejmi fluturon kënga  
përmbi fusha, male, Shqipëri.

*Refreni:*

He, moj Korçë... etj.



# FESTA E MADHE

MUZ. Sotirag Vangjeli  
TEKS. Met Gjergji


KOMP. MIKS

The musical score is written on ten staves. The first two staves are for piano accompaniment in G major (one sharp) and 2/4 time. The third staff is the vocal line, marked 'Canto', in 3/8 time. The lyrics are in Albanian. The score includes various musical notations such as clefs, key signatures, time signatures, and dynamic markings like 'molto'.

U shkri bora ma-jo-ve t'Mo-ra-vës gzimi sot për-  
hidhei sy ndër sy Udhë-heqsi tek ti paska  
ardhur. Eshite shtruar këmbë kryq tek ty. Udhëheqsi.  
tek ty paska ardhur. Eshite shtruar këmbë kryq tek ty


hej moj Korcë do te rrjedhin ngjarjet si rëkete e  
shpatit mbi de-voll. Po kjo di-te 'kjo o ditë






mo - dhe zën e tij gjith - man do ta kujtoj. Flet En-


Komp barrash



veri zemrat hapin dy-ert njerzit kok më kok mbaj-





vesh se po flet o biri madhi tyre




diedhi qe ndrilit në çdo rebesh ...

Flet En-ve-ri




zemrat hapin dy-ert njerzit kok më kokë mbajne



vesh

se po flet o biri madhi tyre.





Handwritten musical score for the first system. It consists of two staves. The top staff is a vocal line with lyrics: "dielli qe ndrit ne cdo rebesh". The bottom staff is a piano accompaniment. The key signature has two flats (Bb, Eb). The system concludes with a double bar line, a repeat sign, and the word "FINE".

Handwritten musical score for the second system. It consists of two staves. The top staff continues the vocal line with lyrics: "cdo re-besh.....". The bottom staff continues the piano accompaniment. The system concludes with a double bar line and a final cadence.

## GREVA E ARSIMTARËVE TË KORÇËS E VITIT 1924

Lëvizja demokratike në Korçë në vitin 1924 filloi me grevën e mesuesve. Në këto vite mësuesit e këtij rrethi kanë qenë aktivizuar dhe organizuar në lëvizjen demokratike. Mësuesit kanë qenë të nderuar dhe të respektuar nga populli jo vetëm për detyrën fisnike dhe për jetën ekonomike e shpirtërore afër masave të popullit, por edhe për rolin e madh që luajtën gjatë Rilindjes Kombëtare e sidomos gjatë dy dekadave të para të shekullit tonë. Në Korçë, gjatë kësaj periudhe, lufta në fushën e arsimit mori formën e një dueli të hapur dhëmb për dhëmb midis shkollës shqipe dhe greke. Kjo luftë u zhvillua e mprehtë dhe gjithmonë brenda kuadrit politik. Për rolin e madh pozitiv, për veprimtarinë aktive, për kontributin e madh që dhanë në fitoren e shkollës shqipe, për kurajon e për sakrificat, mësuesit u bënë akoma më të dashur për popullin. Pjesa më e mirë e kuadrit të mësuesve të vitit 1924 kishin jetuar aktivisht rrugën e vështirë në të cilën eci arsimit shqiptar deri në këtë kohë. Ata jetonin në atmosferën e përpjekjeve të forcave demokratike përparimtare për t'u organizuar, jetonin në atmosferën e shoqërive që ishin ngritur si: «Lidhja shoqërore e arsimtarëve të Korçës dhe të qarkut», «Shoqëria e arteve të bukura», 'Shoqëria e studentëve «Shpresa», Shoqëria e grave «Përlindja», «Lidhja e nëpunsave të Prefekturës së Korçës» etj., bile ishin ngritur shoqëri edhe nëpër fshatra, në Boboshticë, Ziçisht, Hoçisht. Si anëtarë të «Lidhjes shoqërore të arsimtarëve» të Korçës ishin 60 mësues<sup>1)</sup>.

Qeveria reaksionare gjatë viteve 1922-1924 i trajtoi keq mësuesit. Në fund të vitit 1923 në Korçë dhe në qarkun e saj mësuesit kishin tre muaj që nuk ishin paguar. Në këtë gjendje ndodheshin arsimtarët e gjithë vendit. Ata ndjenin mospërfilljen dhe brutalitetin e zyrtarëve kur kërkonin rrogat. Krizat që kishin pllakosur, shtrenjtësia e madhe e bënë akoma më të vështirë gjendjen e tyre dhe të familjeve të tyre. Veç kësaj, mësuesit i përshkonte ndjenja e



pakënaqësisë ndaj veprimtarisë politike dhe ekonomike të qeverisë feudo-borgjeze që ishte në fuqi e që synonte të shtypte dhe të likuidonte forcat demokratike e përparimtare të vendit.

Këto shkaqe në këto kushte bënë që mësuesit e Korçës të hidhen në një grevë, e cila mbeti më e rëndësishmja dhe më e organizuara ndërmjet grevave të këtij lloji në prag të Revolucionit Demokratiko-Borgjez të Qershorit. Greva u zhvillua brenda kërkesave ekonomike, por pakënaqësia shtrihej përtej këtyre kërkesave.

Qarqet qeveritare të asaj kohe e konsideronin shkollën jashtë politikës kështu që edhe mësuesit me këtë sy i shikonin.

Greva filloi me 2 janar 1924. Mësuesit kishin tre muaj që nuk ishin paguar për tetorin, nëntorin dhe dhjetorin. Më 31 dhjetor 1923 një komision përfaqësues i paraqitet prefektit duke kërkuar pagimin e rrogave të mësuesve<sup>2)</sup>. Ky komision mbasi mori nga prefekti vetëm premtime, por asgjë konkrete, u largua në heshtje. Në sallën e foshnjorës (arsim parashkollor) u organizua një mbledhje e gjithë personelit të shkollave të qytetit (fillore e foshnjore) pa bujë ku u bisedua për grevën<sup>3)</sup>. Midis udhëheqësve të grevës telegramet zyrtare përmendin N. Mitace, M. Bakalli, F. Burnazi, të gjithë mësues. Greva i kishte caktuar kërkesat që ditën që u shpall. Prefekti me qëllim që të parandalonte grevën për të cilën kishte marrë informata, lajmëron mësuesit me datën 2.I.1924 për të tërhequr rrogat, por greva kishite filluar.

«Sot pothuaj gjithë shkollat e qytetit u mbyllën. Mësuesit kërkojnë pagimin e rrogës deri në fund të vitit tue refuzue me marrë tetuerin»<sup>4)</sup> njoftonin qeveritarët.

Grevistët kishin bërë edhe parashikimin e përafërt të kohës që do të vazhdonte greva. Organet qeveritare ishin të informuara për këtë. Prefekti i njoftoi organet eprore.

«Liceu u mbyll qysh dje. Thuhet se nuk do të hapet deri me datën gjashtëmbëdhjetë»<sup>5)</sup>.

Qeveria ishte e shqetësuar dhe synonte që ta pezullonte sa më shpejt grevën e të stabilizonte gjendjen. Për këtë ajo u përpoq të kombinonte kërcënimet me lëshimet<sup>6)</sup>. Me datën 4 Ministria e Punëve të Brendshme miratoi propozimin e prefekturës dhe i kërkoi Ministrisë së Arsimit:

«Të kini mirësinë me dhanë urdhërat më të shpejta për transferimin e mësuesve që propozon ajo prefekturë» (mësuesit e përmendur më sipër R.H.)»<sup>7)</sup>



Ministria e Arsimit lëshoi urdhërin për pagimin e rrogës së tetorit si një lëshim, por e shoqëroi me kërcënimet:

«Në qoftë se mësuesit nuk do të kthehen në punë, të merren masa ligjore, por profesorët ose të pranojnë një muaj rrogën ndryshe janë të pushuar»<sup>8)</sup>.

Përgjigjja e ministrisë i zemëroi dhe i revoltoi më shumë grevistët, por nuk i trembi. Ata ishin aq të organizuar dhe kishin aq pjekuri politike sa të mos mashtroheshin nga lëshimi i parë dhe të mos tërhiqeshin para kërcënimit të hapur të ministrisë. Ata vazhduan përpjekjet dhe agjitacionin më me forcë tek mësuesit e fshatrave për të marrë pjesë edhe ata në grevë. Si rezultat një pjesë e tyre u bashkuan me grevistët dhe numri i përgjithshëm i tyre arriti në 60 veta. Në librin «Lëvizja punëtore në Shqipëri» nuk na duket i saktë pohimi se: «në këtë grevë u bashkuan edhe gjashtëdhjetë mësues të fshatrave. Kështu që të gjitha shkollat e rrethit u mbyllën»<sup>9)</sup>.

Qyteti në këtë kohë kishte gjashtë shkolla fillore dhe tre foshnjore. Po t'u shtojmë këtyre profesorët e liceut dhe mësuesit e shkollave të fshatrave më të afërta arrihet shifra gjashtëdhjetë. Sipas statistikave dhe kuadrit të vitit 1923-1924 pjesa tjetër e mësuesve mezi e arrin këtë shifër. Prefekti propozoi që të pushoheshin të gjithë grevistët dhe të riorganizohej arsimi në qytet me mësuesit e fshatrave<sup>10)</sup>. Shifra gjashtëdhjetë përmendet në njoftimin që merr konsullata italiane nga nëpunësi i saj në Korçë, nga merret vesh gjithashtu se grevistët e shtrinë agjitacionin edhe në fshatrat më të afërta.

«... Kjo i ashpërsoi shumë grevistët, të cilët deri më sot jo vetëm që nuk janë kthyer në detyrë, por kanë nxitur të bëjnë greva gjithashtu kolegët e tyre të fshatrave më të afërta, të cilët ndodhen në të njejtat kushte e kështu numri i tyre është tani rreth gjashtëdhjetë<sup>11)</sup>.

Fjalët grevë e përgjithshme janë përdorur në korrespondencë, duke patur parasysh qytetin.

Në qytet greva e mësuesve gjeti miratimin dhe përkrahjen e masave të gjera të popullit, të nxënësve dhe të shtypit përparimtar. Organet qeveritare e njohën këtë realitet. Prefektura midis të tjerash i njofton ministrisë:

«Lypset që t'ju baj të njoftun pa më marrun masat e nevojshme se përgjithësisht mësuesit e shohin me sy të mirë këtë grevë tue pasun uzdajë se do të bjerë një përmirësim ndër pagat mbas sodit, ashtu dhe populli dhe fletoret e përkrahin»<sup>12)</sup>.



Përballë qëndresës së grevistëve, organizimit të tyre dhe përkrahjes që pati nga masat e popullit, nga nëpunësit e vegjël dhe nga shtypi përparimtar, qeveria u detyrua të bëjë një lëshim të ri të shoqëruar përsëri me një kërcënim që këtë herë mori formën e një ultimatumit. Pasi shkoi problemi deri në Këshillin e Ministrave, Ministria e Arsimit e formuloi kështu urdhrin e ri:

«Meqenëse me vendim të këshillit ministrues ju paguhen dy rroga, ata që insistojnë në qëndrim do të quhen si të pushuem. T'i lajmëroni për herë të fundit»<sup>13)</sup>.

Lajmi u shpërnda menjëherë. Grevistët qëndruan në kërkesat e tyre. Ata kishin organizuar ndihmën ekonomike për ata mësues grevistë që ishin në gjendje shumë të vështirë ekonomike e që nuk kishin burime e mundësi të përballonin jetën nga ana financiare. Kjo ndihmë u shpërnda në të holla në formë huaje brendapërbrenda mësuesve për t'u kthyer përsëri kur të merreshin rrogat<sup>14)</sup>. Organizatorët e grevës ishin njëkohësisht në drejtim të «Lidhjes së shoqërisë të arsimtarëve të Korçës.» Grevistët kishin zgjedhur «komisionin arsimor» që drejtonte grevën dhe zhvillonte biseda me organet qeveritare në emër të grevistëve. Këtij komisioni prefekti i komunikoi vendimin e ri të lartpërmendur, duke e shoqëruar me premtimin se do të ndërmjetësonte pranë qeverisë në Tiranë që t'u paguhej së shpejti edhe dhjetori e janari, po qe se grevistët do të pranonin të merrnin dy rroga dhe do të fillonin menjëherë punën. Komisioni u tërhoq pa dhënë asnjë përgjigje dhe filloi të studjojë kushtet e reja. Më 11.I.1924 ky komision thirri mbledhjen e gjithë grevistëve ku u riformuluan kërkesat në kushtet e reja që u krijuan. Grevistët pranonin të merrnin dy rroga me kusht që ministria të zotohej t'u paguante dhjetorin dhe janarin së bashku në fund të janarit, zotim që ata e konsideruan se e angazhonte dhe impononte ministrinë dhe nuk u mjaftuan me premtimin gojor të prefektit që u duk i pasigurtë<sup>15)</sup>.

Më 12 janar këto kondita të formuluar nga mbledhja e grevistëve iu paraqitën prefektit nga komisioni arsimor. Prefekti, i cili tre ditë rresht thërriste komisionin për përgjigje me anën e policisë, kur dëgjoi konditat e reja të cilat në thelb nuk ndryshonin nga të parat dhe greva nuk mund të merrte fund, në çast i njoftoi komisionit se të gjithë mësuesit pushohen nga puna sipas urdhërit të ministrisë. Pas kësaj prefekti menjëherë i propozon ministrisë riorganizimin e arsimit me mësuesit e fshatit si u përmend më lart.



Ngjarjet deri në fund të grevës u zhvilluan kështu. Inspektori i arsimit provokoi një mbledhje të të gjithë grevistëve në marrëveshje me udhëheqësit e saj. Në këtë mbledhje grevistët hoqën dorë nga kërkesa e rrogës së janarit sipas motivit. «Buxheti financiar i vitit 1924 nuk është i miratuar» (u miratua më 20 mars 1924). Grevistët pranuan të zëvendësohej zotimi i ministrisë me zotimin publik të inspektorit të arsimit. Më datën 15 janar, ditën e martë greva përfundoi. Mësuesit pasi morën në dorë dy rrogat hapën shkollat. Gazeta «Shqiptari i Amerikës» në artikullin me titull: «Greva e arsimitarëve me ndërmjetësinë e inspektorit të arsimit u pezullua, por nuk u rregullua përfundimisht» e interpreton kështu përfundimin e grevës:

«Me konditat e sipërme greva u pezullua përkohësisht, arsimitarët duke menduar si patriotë, ndonëse e kishin me hak të kërkonin menjëherë edhe rrogën e dhjetorit pëlqyen më mirë të mbyllnin grevën duke u mbajtur pas premtimit të thatë të inspektorit të arsimit»<sup>16</sup>).

Qëndrimi i qeverisë gjatë grevës u karakterizua nga përpjekja për t'a pezulluar atë sa më parë, duke kombinuar lëshimet me kërcënimet e duke u propozuar kompromis grevistëve.

E imponuar nga forca e lëvizjes demokratike në përgjithësi dhe e mësuesve në veçanti për rastin konkret, qeveria jo vetëm u detyrua të bëjë lëshime, por nuk mundi të marrë asnjë masë direkte e të menjëhershme, sepse u trembej pasojave që mund të sillnin këto masa në gjendjen ende të rëndë që ishte krijuar si në planin e përgjithshëm kombëtar ashtu edhe në planin lokal. Por, megjithëkëtë, ajo planifikon masa për të diskriminuar dhe ndeshkuar mësuesit grevistë, sidomos udhëheqësit e grevës, në rrethana, në rrugë, më të përshtatshme e më të favorshme për të. Menjëherë mbas mbarimit të grevës ministria e arsimit njofton:

«Raporti i asaj inspektorije mbi zhvillimin dhe shkaktoret më të parë të grevës u muar në kujdes dhe ruhet për t'u vue në zbatim masat disiplinore për më tutje nga fillimi i vitit shkolluar që vjen...<sup>17</sup>).

Me rastin e miratimit të buxhetit financiar të vitit 1924, më 20 mars të gjithë nëpunësit u paguan për janarin e shkurtin me përjashtim të mësuesve. Këto e të tjera rrugë janë pjesë e tërë politikës që ndoqi qeveria reaksionare e kohës për të frenuar e për të mbytur lëvizjen demokratike të mësuesve, por pa sukses, sepse lëvizja e përgjithshme demokratike ishte në ngritje dhe vendi po ecte drejt revolucionit demokratiko-borgjez të qershorit.



Greva e arsintarëve të Korçës pati rëndësi në disa drejtime: Ajo i shërbeu ngritjes së lëvizjes demokratike dhe u bë një komunikim i hapur shpirtëror i mësuesve me popullin në raport me qeverinë në fuqi, me qëndrimin dhe luftën kundër saj. Kjo forcoi dhe ngriti lart ndërgjegjen politike sidomos përsa i takonte nevojës së luftës kundër reaksionit, për liri dhe demokraci. Greva u bë shkas që edhe një herë para popullit të zbulohet thelbi antidemokratik, antipopullor, reaksionar, anadollak, i atij shteti që përpiquej të forconte e të konsolidonte klasa feudoborgjeze. Në mënyrë të veçantë greva kultivoi ndjenjën e bashkimit dhe të luftës. Zhvillimi i grevës u shoqërua me kritikën e shtypit përparimtar ndaj qeverisë dhe me përkrahjen e grevistëve dhe të grevës si një rrugë lufte për të drejtat, duke i shërbyer lëvizjes demokratike në përgjithësi. Ajo pati jehonë në të gjithë vendin dhe ndikoi në grevat e tjera që u zhvilluan njëra pas tjetrës në Vlorë, Kavajë, Gjirokastër dhe në rrethe të tjera.

#### PASQYRA E REFERIMEVE

1. «Shqiptari i Amerikës» datë 1.4.1924 Faqe 4.
2. AQSH EMPS, dosja Nr. 4, 1924 Tel 2/2 res.
3. Sipas pohimit të mësuesve veteranë pjesëmarrës në mbledhjen dhe në grevë Persefoni Treni dhe Theofani Papadhimitri.
4. AQSH EMPS dosja Nr. 4 1924 Tel datë 2.I.1924.
5. » » » Nr. 4 1924 datë 5.I.1924
6. » » » Nr. 4 1924 datë 4.I.1924 ministrisë financave:  
«Me rëndësi të posaçme kini mirësinë me na dhanë urdhna me të shpejta financës së Korçës për me u pague mësuesve të atjeshëm rrogat e tyre deri në mbarim të vitit 1923 mbasi nga shkaku i mospagimit kanë mbyllë shkollat». M.P. Brendshme.
7. FMPS dosja Nr. 4 1924 res. 4. I.
8. AQSH FMA dosja Nr. 77.
9. «Lëvizja punëtore në Shqipëri» faqe 96.
10. AQSH EMPS dosja Nr. 4 tel datë 12.I.1924.
11. AQSH Legata italiane, veprimtaria politike datë 4.I.1924.
12. a) AQSH dosja Nr. 4 1924 Nr. 2 res. 10.I.1924.  
b) » F. Legata italiane vep. pol. 6.I.  
c) Gazeta «Shqiptari i Amerikës» 12.I.1924 faqe 1.  
d) » «Koha» 5.I.1924 faqe 2.
13. AQSH FMA dosja 77 1924 Tel. 8.I.1924.
14. Mësuesja pensioniste pjesëmarrëse në grevë Theofani Papadhimitri pohon se ju dha një ndihmë e tillë.
15. «Shqiptari i Amerikës» 12.I.1924 faqe 1.
16. Gazeta «Shqiptari i Amerikës» 16.I.1924, faqe 1.
17. AQSH M. Arsimit Dosja Nr. 77 1924 Tel. 17.I.1924.



**SOKRAT MIO**  
**Artist i merituar**  
**ALEKO SKALI**

## **FILLIMET E LËVIZJES TEATRALE NË KORÇË**

Traditat e teatrit në rrethin e Korçës e kanë nismën e tyre që në shekullin e XIX dhe pikërisht ato fillojnë me 7 mars të vitit 1887, kur u çel shkolla e parë kombëtare shqipe në Korçë, mësonjëtorja, siç u quajt atëhere. Historia e fillimit të lëvizjes teatrale në Korçë është e lidhur me historinë e shkollave të para kombëtare shqipe në këtë qytet.

Në këto mësonjëtoje, kur mbyllej viti shkollor organizoheshin nga mësuesit dhe nxënësit manifestime, ku merrnin pjesë edhe prindër dhe të ftuar të tjerë. Me këtë rast recitoheshin nga nxënësit vargjet e zjarra të Naimit, monologje e dialogje me subjekt patriotik. Ruhet edhe sot e kësaj dite dialogu «Miq dhe armiq» shkruar nga Petro Nini Luarasi dhe të cilin e gjejmë të botuar në librin kushtuar jetës dhe veprës së tij. Dialogu është dhënë në provimet e vitit shkollor 1893, është i shkruar në vargje dhe zë gati tetë faqe të librit.

Në vitin 1890-91, çelte dyert në Korçë Mësonjëtorja tjetër e vajzave. Në shtypin e kohës gjejmë njoftime që thonë se këtu, u mbajt mbledhja e shoqërisë së grave «Ylli i mëngjesit» dhe me këtë rast vajzat luajtën dramën «Vilhelm Tel», e cila la një përshtypje të madhe për dëgjonjësit. Dhe po nga shtypi lokal i atëhershëm mësojmë se me këtë rast «Zoti Mihal Grameno u thërrit në gjyq se botoi në «Lidhja Ortodokse» një lajm ku thoshte se shoqëria «Ylli i mëngjesit» e grave luajti një teatër në shkollën e çupave këtu. Sendi i gjyqit është se përse zoti Grameno shkruajti «Shoqëria «Ylli i mëngjesit» kur kjo shoqëri s'është e njohur prej guvernës».

Kuptohet pse qeveritarët turq nuk e lejonin shfaqjen e dramës «Vilhelm Tel», e cila trajton bashkimin e popullit zviceran kundër zgjedhës austriake. Ajo bënte aluzion edhe për gjendjen e Shqipërisë dhe bashkimin e popullit shqiptar për të hequr qafe zgjedhën 500 vjeçare turke.



Duke ndjekur qëllimin e përhapjes së gjuhës amtare dhe të ndjenjave patriotike në popull, duke luftuar midis dy zjarreve, midis autoriteteve dhe të klerikëve turq nga njëra anë dhe Mitropolisë dhe pasuesve të saj në anën tjetër, mësonjëtorët e para shqipe u bënë djepi i përhapjes së lëvizjes teatrale në popull. Në kohën e luftës për liri, këto mësonjëtorë u bënë streha e ilegalëve kryengritës. Patriotët luftëtarë i këshillonin mësuesit dhe nxënësit që krahas abetarës të mësonin e të këndonin këngët patriotike shqipe, të cilat ua shtonin më shumë zjarrin e zemrës për lirinë e mëmëdheut. Në vitet pas shpalljes së Hyrjetit, klubet e shoqërive patriotike organizonin shfaqje teatrale në vise të ndryshme. Pas hapjes së shkollës normale të Elbasanit, nëpërmjet shfaqjeve teatrale dhe artistike që jepnin këto grupe, grumbulloheshin të holla për të mbajtur këtë shkollë dhe shkollat e tjera shqipe.

Më 13 dhjetor 1909 me inisiativën e Mihal Gramenos shfaqet drama «Besa» e Sami Frashërit, e cila bëri përshtypje të madhe. Në shtypin e kohës me këtë rast lexojmë: «Nisjen e teatros e bëri «Banda e lirisë», duke lojtur ca marshe shumë të bukura. Pastaj u ngrit napa dhe nisi pamja e parë e cila u mbarua me trokitje duarsh të parreshtura. Po kështu në mes të një entuziazmi të paanë u nisën dhe u mbaruan edhe pamjet e tjera... Shumë prej dëgjuesve derdhnin lotë kur Zyberi vritet për të shpëtuar të bijën, Merushen etj.

... Çdo amator, lojti rolin e tij si jo më mirë... Robot me të cilat ishin veshur amatorët ishin shumë të zgjedhura... Ndër të tjera po përmendim se morën pjesë në këtë shfaqje Mihal Grameno, Spiridon Tasi Ilo, Petro Fotografi, Hil Mosi, Qamil Panariti, Thoma Avrami, Nepsi Kerënxa. Grupi u ftua të shkonte së bashku me «Bandën e Lirisë» të jepte shfaqje edhe në qendrën e vilajetit në Manastir dhe të përsëriste këtë edhe një herë në kopshtin e Mitropolisë, por dhespoti e refuzoi kërkesën e bërë. Nga ky shkak u hap dhe një polemikë kundër dhespotit dhe dallaveret e kishës për të mbjellur përçarjet midis shqiptarëve».

Pas luftës së parë botërore atdheu i ynë u shëndrua në një shesh lufte. Në vitet 20 në Korçë fillojnë të organizohen shoqëri të ndryshme amatore të teatrit. Edhe muzikantët e bandës «Vatra» kanë ndihmuar gjithashtu me shfaqjet e tyre, duke zhvilluar një veprimtari të gjërë artistike. Ata vunë në skenë për herë të parë dramën patriotike të Foqion Postolli «Lulja e Kujtimit» dhe «Detyra e mëmës», pjesën «Besa»



të Sami Frashërit e shumë të tjera. Një grup të rinjsh, të frymëzuar nga ndjenja patriotike, së bashku me muzikantët e bandës «Vatra» formuan shoqërinë e «Arteve të bukura» dhe zhvilluan një veprimtari të gjërë muzikore teatrale. Pionierët e kësaj veprimtarie ishin Thoma Nasi, Vangjush Mio, Mihal Ciko. Për herë të parë në vitin 1923, pas një përgatitje të gjatë, amatorët e kësaj shoqërie shfaqën me shumë sukses në prani të autorit, dramën e Mihal Gramenos «Vdekja e Pirros». Këtë si edhe dramën «Besa», amatorët e kësaj shoqërie e shfaqën edhe në teatrin Nacional të Bukureshtit.

Këto shfaqje ishin me dinjitet artistik si nga ana regjizorjale dhe interpretative, ashtu edhe nga kostumet dhe dekorret e bukura të punuara me mjeshtëri nga piktori Vangjush Mio. Krahas pjesëve të autorëve tanë, në këtë kohë u vunë në skenë edhe pjesë të autorëve klasikë si «Romeo e Zhuljeta» dhe disa nga komeditë e Molierit.

Në vitet tridhjetë lëvizja amatore artistike filloi të zhvillohej nën ndikimin dhe drejtimin e grupit komunist të Korçës. Tashmë shfaqjet morën karakter mjaft të theksuar patriotiko-shoqëror dhe përmbajtja, e tyre drejtohej kundër regjimit feudo-borgjez të Zogut dhe gjendjes së mjeruar në të cilën e kishte katandisur popullin tonë ky regjim. Krahas shoqërisë së punëtorëve lindën edhe «Shtëpia e artit», «Rinia korçare», «Shoqëria Agroni», «Shoqëria sportive e liceut» etj.

Grupe teatrale amatorësh u ngritën gjithashtu në katundet Drenovë, Dardhë, Boboshticë, Ravonik etj. Në këto vite në Korçë botohej revista «Bota e re» ku shkruanin Migjeni, Nonda Bulka dhe shkrimtarë e publicistë të tjerë përparimtarë.

Këto grupe teatrale vunë në skenë mjaft pjesë me përmbajtje revolucionare të shkruara nga autorë përparimtarë shqiptarë dhe të huaj.

Një nga pjesët më të realizuara dhe që pati jehonë në atë kohë ishte «Armiku i popullit» e Henrik Ibsenit, vënë në skenë nga «Rinia Korçare».

Në vitet tridhjetë u duk në skenë për herë të parë edhe femra korçare dhe kjo i kushtohet punës bindëse dhe edukuese që zhvillonte në këtë drejtim grupi komunist i Korçës.

Në shtëpinë e artit «Rinia» aktivizoheshin punëtorë të profesioneve të ndryshme. Megjithatë merreshin me punë të rënda, punonin me orar të zgjatur dhe në kushte tepër të vështira, nën censurën e rreptë të qeverisë dhe pengesat e tjera që u sillnin padronët e tyre, ata i përballonin këto me vullnet, këmbëngulje e guxim.



Kur u shfaq premiera me karakter politik «Armiku i popullit», censura zogiste kishte hequr mjaft pjesë sidomos ato ku prekeshin interesat e padronëve shfrytëzues. Por aktorët i thanë të gjitha gjatë shfaqjes, sepse ato preknin ndjenjat e popullit dhe e revoltounin atë kundër shtypjes dhe shfrytëzimit. Gjatë vënies në skenë të kësaj premiere u bë diçka e re, u zhdruk rampa d.m.th. u unifikua skena me publikun. Kombinimi u bë në mënyrë të tillë që aktorët që interpretonin masën, ishin radhitur dhe përzjerë me spektatorët, disa prej tyre ishin shpërndarë në pika të ndryshme, si në galeri, e llozha, kështu që dekori në vend që t'i drejtohej publikut në skenë, i drejtohej publikut të vërtetë. Kjo mënyrë e vënies në skenë krijoi një ekuivok, por më vonë publiku kuptoi se ishin aktorë ata që flisnin në sallë. Në këtë mënyrë revolta mori përpjesëtime të mëdha veçanërisht kur disa nga spektatorët e sallës thërrisnin «Poshtë spekulatorët». Në mbarimin e shfaqjes entuziazmi kishte arritur kulmin. Ky sukses i madh u bë shkak që të nesërmen pjesa u ndalua për t'u dhënë në publik.

Në dhjetor të vitit 1938 qeveria zogiste shpalli të jashtëligjshme shoqërinë «Rinia Korçare» dhe aktivitetin e saj.

Aktivitetet teatrale, rifilluan pas krijimit të Partisë Komuniste Shqiptare, kur u ngrit teatri partizan. Ndërsa menjëherë pas çlirimit aktivitetet artistike dhe veçanërisht lëvizja teatrale, si kudo edhe në rrethin e Korçës mori përpjesëtime të gjera. Teatri amator i Shtëpisë së Kulturës, para se të krijohet teatri profesionist «A. Z. Çajupi» zhvilloi një aktivitet mjaft të dendur artistik. Ai vuri në skenë 12 premiera dhe 11 skeçe që u shfaqen 117 herë.

Kjo tregoi se në rrethin tonë ishin pjekur kushtet për të kaluar nga teatri amator në atë profesionist. Dhe kjo u bë realitet në saje të udhëheqjes së Partisë me në krye shokun Enver Hoxha që kanë krijuar të gjitha kushtet për zhvillimin dhe përparimin e artit dhe të kulturës sonë popullore.



## DISA ASPEKTE TË LËVIZJES AMATORE NË KORÇË NË VITET TRIDHJETË

Me gjithë shtypjen barbare të regjimit anadollak të Zogut vitet tridhjetë në qytetin e Korçës kanë qënë plot aktivitete politike e kulturore. I gjithë ky aktivitet drejtohej e gjallërohej nën ndikimin e grupit komunist të Korçës dhe të shoqërive të ndryshme përparimtare që ishin krijuar në atë periudhë si «Shoqëria Agroni», «Shoqëria Rinia Korçare», «Shoqëria e rrobaqepsëve», «Shoqëria Puna» dhe «Shtëpia e artit».

Regjimi satrap i Zogut, duke ndjerë rrezikun e një lëvizjeje të gjerë revolucionare masive mori masa për të penguar dhe për ta vënë nën kontroll këtë lëvizje. Kështu që me përjashtim të disa shoqërive profesionale që gëzonin të drejta të veçanta dhe në statut, gjitha të tjerat u grumbulluan në një të vetme, në atë që u krijua më 1935 e që u quajt: «Shoqëria jashtëshkollore, Rinia Korçare».

Në korrik të vitit 1935, nën ndikimin e grupit komunist të Korçës, bëhet organizimi i ri dhe zgjedhjet e reja të shoqërisë «Rinia Korçare». Numri i anëtarëve ekzistues në këtë shoqëri u katërfishua pas zgjedhjeve të reja. Kryesia e shoqërisë së re u vu në pozita më luftarake dhe e rriti aktivitetin e saj. Sipas planit të hartuar, më 28 nëntor 1933 ajo do të zhvillonte një sërë aktivitete. Puna filloi dhe koncerti instrumental u përgatit dhe u dha me sukses në datën e caktuar. Në programin e këtij koncerti përveç pjesëve klasike të huaja u dhanë dhe pjesë patriotike e popullore shqiptare. Ky ka qënë i pari koncert që është dhënë para publikut artdashës korçar. Duhet theksuar se ai u ekzekutua nga punëtorë e zanatçinj të qytetit tonë dhe ky qe një sukses i madh.

Përgatitja e dhënia e këtij koncerti tregoi se në qytetin tonë, në gjirin e klasës punëtore kishte forca të tilla që po të aktivizoheshin mund të përgatiteshin aktivitete më të mëdha. Rëndësi kishte që këto shfaqje të merrnin ngjyrë politike dhe të shfrytëzoheshin për zgjimin e ndërgjegjes patriotike dhe të urrejtjes për regjimin anadollak të Zogut që shtypte dhe shfrytëzonte popullin pa mëshirë.

... Ishte viti 1934. Në këtë kohë, «Shtëpia e Artit» në



bashkëpunim me anëtarët e shoqërisë «Agroni» përgatitëshin për të dhënë një shfaqje muziko-teatrale. Në repertorin që kishin hartuar me këtë rast, figuronte dhe një tablo muzikore, tekstin e së cilës e kishin thurrur me kohë dhe kishin menduar të ma jepnin mua për ta kompozuar. Në bashkëpunim me shokët Pandi Stillu, Dhimtër Shamblli, etj. mora përsipër kompozimin e tablosë «Ne jemi studentë», të cilën do ta jepnim së bashku me dy pjesë të tjera teatrale me nga një akt: «Qytetërimi falco», komedi dhe «Të kthehem i verbër», tragjedi; të shkruara nga vetë anëtarët e «Shtëpisë së Artit».

Tabloja muzikore në fjalë ishte një komedi satirike «Bar i studentëve», e cila demaskonte bijtë e bejlerëve e të tregtarëve që i dërgonin me bursë për studime jashtë shtetit dhe ata në vend që të jepeshin pas studimeve, argëtoheshin me djersën e popullit. Ja përmbajtja e saj:

*Ne jemi studentë, jemi djem shkollar,  
Evropën e njohim, botë kemi parë,  
Ne jemi të ditur se kemi studim,  
Për dans edhe ballo kemi marrë mësim  
Dimë ç'është moda, ç'është etiketa,  
Dhe si lohet valle, valle me dy veta,*

*Alla Marcia*

*Ref. Proj me tak-sat e mi-le-tit*

*Jam stu-dent e jam i ri*

*a-në-tar i ar-kës shte-tit*

*prish pa-ra e bëi kër-di*

(po japim refrenin në muzikë)

(Fjalët e kësaj kënge i ka shkrojtur Kristaq Cepa — Kapa)



Një ditë gushti u shpall premiera e kësaj shfaqjeje. Në atë kohë, ishte rregull që pjesët e repertorit përpara se të viheshin në skenë, do të shkonin nën kontrollin e autoriteve qeveritare. Gjer në ditën e shpalljes së premierës nuk ishte bërë asnjë vërejtje nga ana e prefekturës për përmbajtjen e tyre. Mirëpo ditën që do të jepej premiera, një orë përpara shfaqjes, hyrja e kinemasë (sot Kinema Morava) bllokohet nga xhandarmëria dhe anulohet shfaqja. Kjo ngjalli zemërim të madh për publikun. Megjithatë aktiviteti i grupeve artistike nuk u ndal, por u zhvillua në forma të tjera. U përgatitën të tjera tablo e këngë me përmbajtje të mprehtë shoqërore p.sh. «Gruaja me mjekër», në të cilën viheshin në lojë të gjithë ata që martoheshin dhe marrnin prikë ose më mirë të themi që martoheshin për prikë pa marrë parasysh vetitë e gruas.

Ja përmbajtja e kësaj kënge:

*Shumica kur dinë se ka shumë prikë  
E marrin vajzën të jetë dhe shtrigë,  
Të ketë dhe mjekër mustaqe një pash,  
Se syri ju erret, u bëhet kobash.  
Harrojnë se parja harxhohet, fët, fët,  
Dhe zonjën e tyre e marrin për zët  
Ajo mbetet, malli nuk bëhet hallall  
Se lahen gjynahet që kur jemi gjall,*

(refreni në muzikë)

*Tempo di vals*

*Ref. S'kam çë du - a pa - su - ri - në*

*Po s'ma de - shi ze - mra sot*

*Nuk e ble dot da - shu - ri - në*

*me të ho - lla është e kot!*



Gjatë viteve 30 në Korçë u zhvilluan mjaft aktivitetet teatrale e koncertale dhe mori zhvillim krijimtaria muzikore e dalë nga gjiri i popullit, e inkurajuar dhe organizuar nga grupi komunist i Korçës.

U kompozuan gjini të ndryshme si tablo muzikore, këngë korale, mjaft përpunime, harmonizime këngësh popullore, këngët e frymëzuara nga folklori ynë kombëtar si: «Kur më vjen burri nga stani», «Fol e qesh moj sylarushe», «Kur m'u rrite vogëloshe» ose (mez hollë këputura) etj. të cilat patën shumë sukses për atë kohë. Në këtë periudhë, me krijimin e «Shoqërisë Jashtëskollore Rinia Korçare», u dhanë shumë koncerte të ndryshme nga grupet që përmendëm më lart, nga grupet artistike të Liceut si dhe nga artistet e mirënjohura soprane: Maria Kraja, Jorgjia Truja, Lola Gjoka, tenori Kristaq Antoniu, Kritaq Koço si dhe Artistja e Popullit Tefta T'ashko.

Me fillimin e lëvizjes Nacionalçlirimtare këto grupe artistike morën karakter akoma më të theksuar politik e patriotik. Të shumta ishin grupet korale dhe teatrale në qytet dhe në fshatra që zhvillonin aktivitete revolucionare. Në këto grupe mësoheshin e këndoheshin këngë patriotike, partizane, përgatitëshin shfaqje skeçesh teatrale me anën e të cilave ngrinin peshë popullin tonë kundër fashizmit e tradhtarëve. Një numër i mirë i këtyre elementëve morën pjesë në Luftën Nacionalçlirimtare. Në prill të vitit 1945 në Korçë u krijua Shtëpia e Kulturës dhe që atëherë u hapën horizonte dhe perspektiva të mëdha për zhvillimin e aktiviteteve të shumta kulturore dhe artistike.



## KRONIKË KULTURORE-ARTISTIKE

Viti 1976, viti i 35 vjetorit të themelimit të PPSH dhe i Kongresit të 7-të të saj, ishte i mbushur me aktivitete të shumta kulturoro-artistike. Si asnjëherë tjetër vërshuan në skenat, podiumet, qendrat e punës, grupet amatore të vatrave të kulturës dhe të shkollave, duke dhënë një art të pastër të fuqishëm të realizmit socialist, me frymë popullore e taban kombëtar.

Të shumta kanë qenë koncertet, mbrëmjet tematike, konkurset, ekspozitat e arteve figurative dhe fotografike, të cilat pasuruan mjaft jetën kulturoro-artistike të rrethit.

Takimet e ansambleve amatore, teatrove dhe estradave të qendrave të punës, shkollave dhe kooperativave bujqësore ishin nga aktivitetet kryesore në shkallë rrethi që mbushën me gjallëri sallat e shfaqjeve të fshatit dhe qytetit, të qendrave të punës dhe shkollave.

---

Ansambli artistik i ndërmarrjes së qilimave në takimin e ansambleve në shkallë rrethi fitoi flamurin e takimit të zhvilluar në kuadrin e 35 vjetorit të themelimit të PPSH dhe të Kongresit të 7-të të saj. Në këto aktivitete të rëndësishme morën pjesë 8 grupe amatore të qendrave të punës, të cilat sollën në skenat e qytetit, podiumet dhe shfaqjet e dhëna jashtë konkurimit jetën e gjallë, këngën e bukur popullore, vallen dhe zërat e rinj nga gjiri i klasës punëtore. Është karakteristik fakti se këto ndërmarrje po krijojnë fizionominë e tyre artistike. P.sh. ansambli i ndërmarrjes së qilimave po punon për të vënë vazhdimisht në programin e tij këngën popullore dhe vallen popullore të përpunuar, këngët polifonike të rrethit etj. Kurse ansambli i kombinatit të trikotazhit ka në repertorin e tij këngë korale masive, valle të punës etj. Po kështu edhe ansamblet e tjera të qendrave të punës po krijojnë fizionominë e tyre artistike duke pasur në themel artin e realizmit socialist dhe lidhjen organike me traditën artis-





Koncert i shkollës së muzikës «Tefta Tashko Koço»



tike. Të udhëhequra nga organizatat bazë të partisë këto ansamble, me aktivitetet e tyre të përhershme, po bëjnë realitet masivizimin e artit.

Ansambli artistik amator i shtëpisë së kulturës, ka dhënë vazhdimisht shfaqje me cilësi të lartë artistike duke lënë mbresa tek spektatorët e shumtë që kanë ndjekur shfaqjet e këtij ansambli. Shembull pozitiv ishte koncerti i madh i organizuar me rastin e 35 vjetorit të themelimit të PPSH në pallatin e madh të sportit, ku u vlerësua si për anën e nivelit artistik dhe për pjesëmarrjen e madhe të amatorëve të dalë nga klasa punëtore. Ne vazhdimësi të pasurimit të repertorit dhe për gjallërimin dhe futjen e amatorëve në gjirin e tij, ky ansambël po krijon një traditë të mirë artistike, e cila do të zhvillohet akoma më tej për të venë kështu në jetë porosinë e vazhdueshme të Partisë. Ky ansambël në takimin kombëtar në Durrës fitoi flamurin. Nga gjiri i këtij ansambli u krijua ansambli «24 tetori», i cili bëri me sukses një turne jashtë shtetit, që u vlerësua për një nivel të lartë artistik dhe përmbajtje të shëndoshë ideologjike.

Aktiviteti i korit të këngëve karakteristike korçare është mjaft i madh. Fillimin e tij mund ta gjejmë shumë vjet më parë, kur këta amatorë me profesione të ndryshme, të bashkuar nga dëshira e mirë, kanë ruajtur dhe transmetuar këngët e bukura të popullit. Zërin e këtij kori e kemi dëgjuar këtu e 53 vjet më parë, në atë kohë, kur këta burra që sot janë të mcshuar, ishin të rinj. Megjithëse mosha e tyre ka lënë gjurmë në pamjen e tyre, kënga ka mbetur e re, e bukur, e fuqishme. Kjo këngë na fut në botën e luftërave të Skënderbeut, të patriotëve të tjerë, na fut në mësimin e gërmave të gjuhës shqipe, në botën e pasur lirike e deri në heroizmin e ditëve tona të zjarra në epokën e ndritur të Partisë. Ata i këndojnë më shumë dashuri Partisë, «Birit të gjithë Shqipërisë», udhëheqësit të madh të Partisë e popullit tonë shokut Enver, i këndojnë mëmëdheut etj.

Koncertet e tij janë të panumërta si në Korçë, ashtu edhe në gjithë vendin. Ai është tashmë i njohur në gjithë vendin. Radioja dhe televizioni shpërndajnë në të katër anët e vendit këngët karakteristike të tij. Ky kor po punon me shumë kujdes për pasurimin e repertorit me këngë të reja dhe me shtimin e elementëve të rinj.

— — —

Festivalet folklorike në bazë zone dhe rrethi që janë zhvilluar vazhdimisht në rrethin tonë kanë bërë të mundur nxjerrjen e elementëve të rinj, të këngëve dhe valleve të reja



popullore dhe të atyre të përpunuara. Vetëm gjatë muajit nëntor 1976 nga grupet popullore, ansamblet e fshatit dhe qendrave të punës e shkollave u dhanë mbi 150 shfaqje në fshatra dhe në podiumet e qytetit. Këto koncerte janë ndjekur me interes nga publiku ynë artdashës. Vlen të theksojmë se për këto ansamble po tregohet një kujdes i madh për pasurimin e tyre me sa më shumë instrumenta popullore.

Aktiviteti i orkestrës simfonike të Korçës është i madh e i larmishëm. Kjo orkestër vazhdimisht ka ardhur duke e ngritur nivelin e saj artistik dhe ideoprofesional. Mund të përmendim ndër aktivitetet e saj të këtij viti jubilar, koncertet festive për festat e nëntorit që u dhanë në pallatin e sportit, koncertet për Konferencën e 20-të të Partisë, për 35 vjetorin e krijimit të ushtrisë popullore, për 35 vjetorin e formimit të Brigadës I sulmuese. Orkestra simfonike ka mbuluar me aktivitet të një niveli të mirë artistik festivalin e 5-të të këngës së rrethit, festivalin e 8-të të këngës për fëmijë e pionierë si dhe shumë koncerte vokale instrumentale. Kolektivi i saj po bën një punë të mirë në drejtim të analizës së aktiviteteve ku të gjithë marrin pjesë gjallërisht në këto diskutime krijuese. Gjithashtu në repertorin e saj po zënë vënd gjithmonë e më shumë pjesë popullore si suita dhe rapsodi, koncerte për piano dhe orkestër si dhe valle për gajde dhe orkestër etj.

Orkestra frymore e rrethit gjithashtu është ndër më të vjetrat dhe ka një aktivitet të gjerë artistik. Tingujt e saj gjallërojnë rrugët dhe sheshet e qytetit dhe mbushin me optimizëm të gjithë dëgjuesit. Tingujt e kësaj orkestre i ndien në mëngjeset e ditëve të aksioneve masive, në ditët e festave etj.

---

Institucionet e artit profesionist të rrethit tonë, teatri «A. Z. Çajupi» dhe ai i estradës, zhvilluan një aktivitet të dëndur e të larmishëm duke vënë në skenë spektakle me përmbajtje dhe nivel të mirë artistik.


Nga teatri u realizuan premierat «Vajza e uzinës», «Flamur në dallgë» dhe «Djemtë e Bato Gores». Me «Flamur në dallgë» teatri fitoi çmim të tretë në takimin kombëtar të teatrove profesioniste. Në turneun që zhvilloi në disa qytete, trupa e teatrit shfaqti me sukses dramën «Djemtë e Bato Gores», të cilën e dha edhe në një numër fshatrash të rrethit. Ndërsa një grup tjetër aktorësh jepte shfaqje për brigadat e arave që punonin për shkëlqimin dhe grumbullimin e panxhar-sheqerit dhe për nxënësit e shkollave të fshatit.



Teatri i estradës realizoi gjithashtu gjatë kësaj kohe numrat e rinj «Konkursi ynë», «Tinguj gazmorë», «Flladi i nëntorit» si dhe komedinë «Telefoni paralel».

Trupa e estradës zhvilloi një turne në zonat e veriut duke filluar shfaqjet nga qendra industriale e Laçit e deri tek ndërtuesit e hidrocentralit të Fierzës. Gjithashtu u bë edhe një turne në qytetet e Fierit, Vlorës e Lushnjës.

Edhe teatri i kukllave realizoi premierat për fëmijë «Jurkani» me temë nga kufitarët, pjesën «Djaloshi me pagur» me subjekt të Luftës Nacionalçlirimtare, përrallat «Pipipeli dhe Pipinoku» dhe «Fitorja e bletëve». Kjo trupë bëri një turne në qytetet Fier, Vlorë dhe Lushnje si dhe në fshatrat e rrethit si Proger, Tren, Bitinckë etj.



Parku «Rinia» në qytetin e Korçës



Aktivitetet e kulturës masive gjatë vitit 1976 kanë qenë të shumta e të larmishme. Mbrëmjet tematike me temë: «I këndojmë PPSH në jubileun e 35 vjetorit të themelimit të saj», «Të vemë në jetë vendimet e Kongresit të 7-të të PPSH» etj., si dhe konkurset e shumta me temë: «Rruga e lavdishme e PPSH gjatë 35 vjetëve», «Studimi i kapitullit I — II të raportit të shokut Enver Hoxha mbajtur në Kongresin e 7-të të PPSH», si dhe shumë aktivitete të tjera kanë gjallëruar jetën kulturore-artistike të rrethit. Është karakteristike se çdo ditë e më shumë aktivitete po shtrihen gjithnjë në qendra pune e prodhimi, në fshat e shkolla, kjo po bën të mundur aktivizimin në një shkallë më të gjerë të masave të amatorëve dhe shpënieën e artit e kulturës me të gjitha mjetet që ka vënë shteti në dispozicion, pranë masave punonjëse.

Për aktivitete të kulturës masive vlen të theksojmë se cilësia e tyre po rritet për herë e më tepër, duke krijuar edhe forma e rrugë më të larmishme, të cilat po japin një efektivitet më të lartë në drejtim të edukimit klasor revolucionar të masave punonjëse. Këtu nuk po përmendim takimet e bisedat e shumta të zhvilluara me veteranë të Luftës Nacional-çlirimtare, me artistë, mjekë e specialistë të shkencave të ndryshme shoqërore etj. Me aktivitete të kulturës masive shtëpia e kulturës po u përgjigjet më mirë momenteve aktuale në cilësi artistike, duke i pasuruar këto aktivitete me muzikë, filma, shfaqje estrade etj.

---

Gjatë vitit 1976, konkurruan edhe 13 grupe amatore të teatrit dhe të estradës. Premierat e tyre trajtonin probleme aktuale të kohës si edukimin e njeriut të ri, heroizmin e klasës punëtore për ndërtimin e socializmit, mbrojtjen e atdheut, luftën kundër mbeturinave dhe zakoneve prapanike, luftën e klasave në fshat në vitet e para të çlirimit e deri në ditët e sotme. Në këto shfaqje ndjehej fryma e klasës punëtore, shqetësimet, preokupimet e vetë ndërmarrjes, duke goditur fuqishëm të metat që u dalin në punë e sipër dhe njëkohësisht duke nxjerrë në pah bukuritë pozitive, për t'i bërë ato shembull dhe frymëzim për masat punonjëse.

Karakteristike në këtë festival që sigurimi i repertorit të estradave me pjesën më të madhe nga vetë punëtorët e ndërmarrjeve, duke u bërë njëkohësisht krijues dhe interpretues. Masivizimi i amatorëve të klasës punëtore gjatë këtij viti vërtetoi edhe një herë atë që ve në dukje shoku Enver në Kon-



gresin e 7-të të PPSH: «Një zhvillim të madh sasior e cilësor ka marrë lëvizja amatore, e cila krahas artistit profesionist, po luan një rol të rëndësishëm në përparimin e kulturës sonë të re, dhe në edukimin e punonjësve. Është ngjitur në skenë masa, njeriu i punës, punëtori e kooperativisti, gratë, të rinjtë, pleqtë e fëmijët».

— — —

Prej kohësh, shkollat e mesme të qytetit tonë po japin kontributin e tyre në zhvillimin sa më të gjerë të jetës artistike e kulturore të rrethit. Ansamblet artistike të këtyre shkollave po debutojnë me sukses në skenë. Vetëm gjatë muajit nëntor 1976, këto ansamble dhanë 90 shfaqje për punonjësit e qendrave të punës, kooperativat bujqësore dhe për nxënësit e shkollave të tyre. Nveli i shfaqjeve të tyre është i kënaqshëm, larmia e programeve, tematika dhe optimizmi që i përshkon ato, të bëjnë që t'i ndjekësh me vëmendje. Në programet e tyre gjen këngë të ditëve tona, këngë për partinë e shokun Enver, për rininë shkollore aksioniste e për jetën e re. Aty dëgjon recitime nga krijimtaria e poetëve tanë dhe valle të përpunuara popullore e të mirëfillta.

— — —

Në rrethin tonë, nën udhëheqjen e Partisë, shtrirja dhe aktiviteti i institucioneve kulturore në fshat, nga viti në vit ka ardhur duke u zgjeruar. Sot funksionojnë 51 shtëpi kulture; 132 vatra kulture dhe gati në çdo fshat muzeumi i luftës.

Ato zhvillojnë aktivitete në bazë të një programi të studuar, duke siguruar kështu vazhdushmëri dhe gjithanshmëri. Në vatrën dhe shtëpitë e kulturës po vërshon çdo ditë e më shumë masa e gjerë e kooperativistëve, sidomos rinia, e cila merr pjesë aktivisht në grupet artistike dhe në aktivitetet e kulturës masive. Këto institucione, ashtu si në të gjithë vendin, po zhvillojnë një aktivitet të dendur dhe po venë në jetë detyrën e Kongresit të 7-të të PPSH që kultura të vejë aty ku jetojnë e punojnë masat. Me aktivitetet e tyre ato po kontribuojnë fuqimisht për ngritjen e mëtejshme të nivelit kulturor të fshatarësisë.

Vatrat e kulturës së fshatrave gjatë vitit të kaluar zhvilluan takimin e kulturës masive ku u dalluan Bulgareci, Drenova, Gurkuqi, Pirgu etj. Po gjatë këtij viti në fshatra u zhvillua edhe takimi i teatrove dhe estradave, ku u dalluan Bilishti, Doberçani, Lekasi, Progridi, Liqenasi, Polena etj.

Në festivalin folklorik u dalluan Ziçishti, Vithkuqi, Hoçishti, Moçani etj. Të gjitha këto grupe para dhe mbas çdo takimi në mënyrë të programuar, organizuan stafetën artistike në bazë fshati të bashkuar dhe zone.



Ansambli i madh i klasës punëtore dha shfaqje më 1 nëntor 1976, ditën e çeljes së Kongresit të 7-të të PPSH. Ky koncert u ndoq me shumë interesim nga më se 2500 pjesëmarrës që mbushin plot shkallët e pallatit. Ai ishte një manifestim i shkëlqyer artistik në këtë ditë të shënuar. Aty jehoi e gjallë e fuqishme kënga për Partinë dhe shokun Enver, aty tingujt e melodive, vallet e instrumentat popullore dhanë një harmoni të pasur ngjyrash të artit tonë popullor.

---

Artet figurative në rrethin tonë kanë marrë një zhvillim të madh. Tashmë pothuaj se për çdo vit çelen ekspozita kolektive dhe personale, të fotografisë artistike etj. Këto aktivitete kanë lënë gjurmë tek vizitorët. Vetëm po të shikojmë shtimin numerik të veprave të krijuara do të nxjerrim një konkluzion të drejtë: Në ekspozitën e 35 vjetorit të themelimit të PPSH u punuan nga krijuesit mbi 120 vepra në të gjitha gjinitë e artit, nga më se 34 autorë. Ndërsa në ekspozitën kombëtare u paraqitën 24 punime të 15 autorëve. Po ajo që është më e rëndësishme si zgjerimi tematik, larmia dhe freskia e krijimeve, është aktivizimi i krijuesve me tema të mëdha si në gjininë e kompozimit etj.

Tashmë është bërë traditë edhe me fotografinë artistike të hapen ekspozita të ndryshme si për përvjetoret e krijimit të ushtrisë, të armës së sigurimit e të policisë popullore, të aktiviteteve të ndryshme të ndërmarrjeve e të shtëpisë së kulturës etj.

---

Në kuadrin e 35 vjetorit të themelimit të PPSH dhe të Kongresit të 7-të të saj, në muajin nëntor 1976 u zhvillua ceremonia e shpalljes së fituesve të festivalit të teatrove-estradave dhe asambleve të qendrave të punës e prodhimit si dhe fituesit e konkursit letrar-artistik të shpallur në këtë kuadër.

Ndër pjesëmarrësit në festivalin e asambleve të këngëve e valleve me flamur u nderua ai i ndërmarrjes së qilimave, me çmim të parë ansambli i fabrikës së lëkurë-këpucës, me çmim të dytë ato të ndërmarrjes së prodhimit të veshjeve dhe të ndërmarrjes së ndërtimit, me çmim të tretë ansamblet e kombinatit të trikotazhit dhe të stacionit të makinave dhe traktorëve.

Për grupet e teatrit, grupi i sektorit 'Sheqeras të ndërmarrjes bujqësore të Maliqit u nderua me flamurin e takimit, me çmim të parë, grupi i shtëpisë së kulturës «16 Tetori», me çmim





Në park



të dytë grupi i spitalit, ndërsa me çmim të tretë u nderua shtëpia e kulturës Drithas të ndërmarrjes bujqësore të Maliqit.

Për pjesët me një akt, çmim i parë ju dha grupit të ndërmarrjes metalike, çmim i dytë grupit të shtëpisë së kulturës Mborje-Drenovë.

Ndërsa për grupet e estradës, flamuri i festivalit iu dha grupit të ndërmarrjes së përpunim-drurit, çmim i parë iu dha grupit të uzinës së instrumentave.

---


Zotimet në krijimtarinë artistike — letrare për nder të 35 vjetorit të themelimit të Partisë dhe Kongresit të 7-të të saj.

Në sektorin e letërsisë:	
— Romane	5
— Drama e komedi	8
— Vëllime me vjersha	6
— Poema	4
— Vëllime me tregime	5
— Novela	1
— Skenar filmi	1
Në sektorin e arteve figurative	
— Kompozim në pikturë	15
— Kompozime në skulpturë	8
— Kompozime të aplikuara	3
— Portrete në pikturë	25
— Portrete në skulpturë	10
— Peisazhe	30
— Grafika	16
— Pllakate	2
— Karrikatura	3
Në sektorin e muzikës	
— Opera	1
— Opereta për fëmijë	1
— Rapsodi për orkestër	1
— Kantata	3
— Romanca	5
— Këngë masash	45
— Këngë për pionierë e fatosa	25
— Valle instrumentale	2
— Tablo muzikore	4

Këto zotime u tejkaluan nga krijuesit të cilët dhanë një numër më të madh krijimesh në aktivitetet e vitit jubilar.


---





Grupi amator i ndërmarrjes së qilimave





Koncert nga ansambli folkloristik i qytetit të Korçës.





Vallëtarë popullore



RRETHET E KRIJIMTARISË ARTISTIKE PRANË SHTËPISË  
SË KULTURËS DHE KRIJIMTARISË POPULLORE  
«ALI KELMENDI» KORÇË

Nr.	Lloji	Puno- njës gjith- ësej	Nxënësia		Punëtorë		Nëpunës		Kooperativistë	
			M	F	M	F	M	F	M	F
1.	Rrethi i arteve figurative	27	—	—	19	1	6	1		
2.	Rrethi letrar	34	2	1	7	5	18	—	1	
3.	Rrethi i muzikës	18	6	4	4	—	2	—	2	

GRUPET ARTISTIKE PRANË SHTËPISË SË KULTURËS DHE  
KRIJIMTARISË POPULLORE «ALI KELMENDI» KORÇË

Nr.	Lloji	grupe	Pjesë- marrës	Nxënësia		Punëtorë		Nëpunësia		Pensionistë	
				M	F	M	F	M	F	M	F
1.	Ansambl i shtëpi- së së kulturës	1	80	—		20	45	10	5		
2.	Kori karakteristik	1	43	1		10		17		15	
3.	Ansambl folklorik	1		34		30				4	
4.	Solistë lirikë e të këngës masive	2	28	—	6	4	7	9	2		
5.	Komplekse	1	12				10		2		
6.	Grupe valle	2	22			10	12				
7.	Orkestra simfonike	1	39	7	8	4	2	13	5		
8.	Orkestra frymore	1	29	2		25	2				



## TREGUESI I LËNDËS

	Faqe
<b>Pirro Lako</b> — Dekada pune e lufte, dekada fitoresh .....	3

### PROZË TREGIMTARE DHE POEZI

<b>Gaqo Mani</b> — Manushaqja (tregim i jetuar) .....	10
<b>Sotir Lashova</b> — Ballë për ballë armikut (skicë) .....	17
<b>Sefedin Sinaj</b> — Xha Suloja dhe partizanët .....	20
<b>Muharrem Xhaxho</b> — Altini (skicë) .....	25
<b>Andon Mara</b> — «Bualli i kënetës» nuk këndon më (përshkrim) .....	30
<b>Ilia Grabocka</b> — Partia, Kënga më e bukur për ty metalurgji, Gjyshja Dade .....	37
<b>Kastriot Nuni</b> — Këngë për Kushtetutën .....	40
<b>Xheladin Bleta</b> — Ç'ra për rreth ky nur i rrallë, Kur kthehet kooperative nga puna .....	41
<b>Kozeta Qirio</b> — Moshatares dëshmore .....	43
<b>Rafail Stavre</b> — O mëmë e dashur, Dhe toka mori frymë .....	44
<b>Julia Naçi</b> — Pranverë në brigjet e fortesës .....	46
<b>Hamza Koçiu</b> — Lirikë, Elegji për Mehmet Pepin .....	47
<b>Elmaz Leci</b> — Sa herë pushkën e kam prekur, Rend transheve të kuqe, Trim' o për liri .....	51
<b>Limoz Hinaj</b> — Vogëlushi partizan, Balladë për çobanin .....	56
<b>Petraç Samsuri</b> — Kënga juaj zjarr e flakë .....	58
<b>Bashkim Gjoza</b> — Këngë thur kavalli, Kthehem, Xhaxha Nexhipi .....	59
<b>Resmi Çorbaxhiu</b> — Tek të rënë .....	64
<b>Polikron Pulluqi</b> — Heroit, Xha Halimi dhe unë .....	66
<b>Nafail Dangaj</b> — Bariu i vogël .....	68
<b>Vangjush Ziko</b> — Poezia .....	69
<b>Zhivko Mile</b> — Si luan të rriti .....	70
<b>Rezo Çuli</b> — Epilog i një poeme për Riza Cerovën, Studentja ushtare .....	72



## PJESË STUDIMORE

	Faqe
<b>Gaqo Opingari</b> — Popullsia e rrethit të Korçës dhe dinamika e rritjes së saj .....	74

## MUZIKË

<b>F. Gërmenji</b> — <b>J. Minga</b> — Ditëlindja e madhe .....	83
<b>P. Samsuri</b> — <b>P. Sholla</b> — Më zgjoi këng' e fshatit .....	86
<b>Xh. Jorganxhi, J. Minga</b> — Vajz' e fushës, djal' i malit .....	89
<b>M. Treska</b> — <b>Gj. Kote</b> — Motive festivali .....	91
<b>M. Gjergji</b> — <b>S. Vangjeli</b> — Festa e Madhe .....	93

## DOKUMENE DHE MATERIALE

<b>Riza Hyso</b> — Greva e arsimtarëve të Korçës e vitit 1924 .....	97
<b>Sokrat Miho</b> — <b>Aleko Skali</b> — Fillimet e lëvizjes teatrale në Korçë.	104
<b>Kristo Kono</b> — Disa aspekte të lëvizjes amatore në Korçë në vitet tridhjetë .....	108
Kronikë kulturore artistike .....	112

Fotot nga: T. Bellovoda, M. Vithkuqi — G. Koti



---

Tirazhi: 1000 kopje

Formati: 60 x 88/16

Stash. 2204-77

---

Shtypur: Kombinati Poligrafik  
Shtypshkronja «MIHAL DURI» — Tiranë, 1977